**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KUJDESIT SOCIAL, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE**
**DREJTORIA E MBROJTJES DHE PËRFSHIRJES SOCIALE**

**Nr.**4027/3 **prot.** **Elbasan më** 10.09.**2025**

# PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MBROJTJEN SOCIALE

**PËR BASHKINË ELBASAN**

**2025-2028**

**Miratuar me vendim nr.**102**, datë**23.9.2025 **të Këshillit Bashkiak, Elbasan**

# PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MBROJTJEN SOCIALE 2025-2028

Dokumenti **Plani Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028**, në Bashkinë Elbasan është rishikim i Planit për Mbrojtjen Sociale 2024-2027.
Ky dokument është hartuar mbi bazën e konsultimeve, diskutimeve dhe këshillimeve me profesioniste/profesionistë, eksperte/ekspertë dhe aktore/aktorë të fushës së NE, PAK dhe Shërbimeve Sociale në Bashkinë Elbasan.

**Plani Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale është punuar nga grupi i punës:**

- Armand Shehu, Zv/Kryetar i Bashkisë Elbasan
- Dorina Rroseni, Drejtor i Përgjithshëm i Kujdesit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
- Eltiona Kolla, Drejtor i Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale
- Nadire Kreka, Përgjegjëse Sektori Për Mbrojtjen Gjinore, Diskriminimin, Etnitë
- Lindita Senia, Përgjegjëse Sektori i Kujdesit të Shtresave në Nevojë, Mosha e Tretë dhe Pakicave Etnike.
- Danjela Shuli, Drejtor i Shërbimeve Sociale
- Edvin Palloshi, Drejtor i Përgjithshëm i Agjensisë së Shërbimeve Sociale
- Elona Kaçi, Specialist Drejtoria e Financës
- Lorena Haxhiymeri, Koordinatori i Performancës dhe Statistikave
- Anëtaret dhe anëtarët e Forumit të Qeverisjes së Hapur (OGP)

# PËRMBATJA

**HYRJE** ........ 4.

KUADRI INSTITUCIONAL ........ 7.

METODOLOGJIA E PËRDORUR ........ 8

**I. ANALIZA E SITUATËS** ........ 9.

1.1 PROFILI I BASHKISË ELBASAN ........ 9.

1.2 MBROJTJA SHOQËRORE ........ 11

1.2.1 NDIHMA EKONOMIKE ........ 11.

1.2.2 AFTËSIA E KUFIZUAR ........ 14.

1.2.3 SHËRBIMET SHOQËRORE ........ 16

**II. ARRITJET DHE VËSHTIRËSITË NGA ZBATIMI I PLANIT SOCIAL 2020-2022** ........ 23

**III. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT** ........ 26

**3.1 VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË** ........ 26

**3.2 OBJEKTIVAT SPECIFIKË** ........ 27

**IV PLANI I ZBATIMIT, MATRICA DHE BURIMET FINANCIARE** ........ 29.

**V SHTOJCA PER PAKICAT ROME E EGJIPTIANE** ........ 54.

## HYRJE

**Plani Vendor i Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028** Elbasan PVVMS përshkruan prioritetet e Bashkisë Elbasan në fushën e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale deri në vitin 2028. Ai përmban gjithashtu një listë masash që ndikojnë në përfshirjen sociale dhe luftimin e varfërisë, burimet njerëzore (punonjëset/punonjësit) dhe fondet publike (qendrore dhe vendore) dhe jopublike të parashikuara për mbështetjen, riintegrimin dhe përfshirjen sociale të njerëzve dhe familjeve në nevojë. **Plani** bazohet në Vizionin afatgjatë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për përfshirjen sociale që synon t'i sigurojë çdo qytetare/qytetar të shqipërisë, grua/burrë, vajzë/djalë, pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore, të cilat rikonceptohen me prioritet familjen dhe duke adresuar "qasjen e ciklit të jetës". **Plani** synon të kontribuojë në krijimin e një klime që synon dobësimin ose ngadalësimin e përjashtimit social.

**Plani** i paraqitur ka si qëllim të rishikojë dhe konsolidojë **Planin Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028**, në Bashkinë Elbasan duke zgjatur harkun kohor të tij/saj deri në vitin 2028.

Dokumenti është hartuar mbi bazën e konsultimeve, diskutimeve dhe këshillimeve me profesioniste/profesionistë, eksperte/ekspertë dhe aktore/aktorë të fushës së NE, PAK dhe Shërbimeve Shoqërore në Bashkinë Elbasan.

**Plani ka në fokus familjen, personat me aftësi të kufizuara dhe individët në nevojë "në të[1] gjithë diversitetin e tyre". Plani prezanton mbështetjen për familjen nëpërmjet:**
**i) zbatimit me efikasitet të skemës së NE e cila shenjëstron familjet më të prekura nga varfëria;**
**ii) ofrimit të NE nga buxheti lokal për familje në nevojë që nuk përfitojnë ndihmë nga skema e NE;**
iii) inkurajimit dhe mbështetjes së familjeve për daljen nga skema NE duke riintegruar në tregun e punës (strategjia e daljes) anëtarët/anëtaret në moshë pune të familjeve përfituese;
iv) akordimit të ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të porsalindura;
v) paketës mbështetëse me subvencione shtesë/bonuse për vaksinimin dhe arsimimin e fëmijëve;

[1] është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja "në të gjithë diversitetin e tyre", në përputhje me terminologjinë e përdorur në Planin Vendor të Veprimit të Barazisë Gjinore (PVVBGJ) të bashkisë Elbasan 2025-2030,që të theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të të gjithë individëve, e në mënyrë të veçantë, të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cenueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuara, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj., pra nga të gjithë grupet në shoqëri. Ky term gjithashtu përdoret gjerësisht në dokumentet e Bashkimit Evropian, sidomos ato që janë pjesë e acquis të BE-së për barazinë gjinore, ku specifikisht adresojmë Strategjinë e BE-së për Barazinë Gjinore 2020 – 2025, si dhe Planin e Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III 2021 – 2025/2027 (EU GAP III).

vi)ofrimit të paketës së ndihmës në natyrë;
vii) mbulimit të shpenzimeve të transportit për ndjekjen e ciklit arsimor të detyrueshëm për fëmijët;
viii) ofrimit të lehtësirave për sigurimin e ngrohjes në periudhën e dimrit;
ix) prioritizimit të familjeve në NE në skemat e strehimit nëpërmjet ofrimit të bonusit të qirasë për shtëpi.

Mbështetja dhe kujdesi për Personat me Aftësi të Kufizuar prezantohet në **Plan** nëpërmjet zbatimit të legjislacionit të aftësisë së kufizuar, modelit të ri bio-psiko-social të vlerësimit dhe përfitimit të aftësisë së kufizuar për të rriturin/rriturën apo fëmijën. **Plani** prezanton:
i) mbështetjen me pagesë në CASH të personave/personave me aftësi të kufizuara;
ii) ngritjen e shërbimeve shoqërore të reja mbështetëse për PAK dhe konsolidimin e shërbimeve ekzistuese;
iii) institucionalizimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për të krijuar një rrjet shërbimi mbështetës për PAK në territorin e Bashkisë Elbasan;
iv) ndërtimin e protokolleve që integrojnë pagesat në CASH me shërbimet shoqërore për personat/personet me aftësi të kufizuara.

---

***Plani Vendor i Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028*** *synon të zhvillojë një sistem të integruar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët/individet në nevojë, inkurajon pjesëmarrje të plotë dhe efektive në shoqëri nëpërmjet konsolidimit të shërbimeve ekzistuese dhe* zgjerimit të shportës së shërbimeve me shërbime të reja.
Plani ofron një ndërthurje të burimeve financiare për realizimin e tij/saj duke gërshetuar alokimet nga buxheti i shtetit për NE dhe AK, fondet nga të ardhurat e Bashkisë Elbasan, Fondin Social për ngritjen e shërbimeve shoqërore të reja (shporta e shërbimeve) dhe fonde nga donatore/donatorë të ndryshëm/ndryshme.
Plani krijon një mjedis mundësues dhe mikpritës për organizatat e shoqërisë civile. Shërbimet shoqërore të ofruara nga sektori jo-publik – kryesisht të financuara nga donatore/donatorë – janë një përpjekje për të mbushur boshllëqet në ofrimin e shërbimeve publike në Bashkinë Elbasan. Bashkëpunimi i mirë midis Bashkisë Elbasan dhe sektorit jo-publik garanton mbrojtje sociale sa më të plotë për familjen dhe individin/individen në nevojë.
Plani përcakton role, përgjegjësi si dhe një kornizë monitorimi e cila orienton të gjithë aktorët/aktoret e përfshirë/a në zbatimin me korrektësi dhe respektimin e standardeve të miratuara, duke garantuar një cilësi më të mirë për fëmijët, individin/individen dhe familjen në nevojë.

Parimet mbi të cilat është ndërtuar dhe do të zhvillohet **Plani Vendor i Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028** janë:
• Të drejtat civile, barazia dhe mosdiskriminimi: Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ/individe në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara, etj.
• Mbrojtja: Grupe të veçanta, duke përfshirë fëmijët, janë subjekt i/e mbrojtjes së veçantë, bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.
• E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit: Një mjedis i/e përshtatshëm/përshtatshme duhet të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve/individeve.
• Pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikëpamjeve: Individët/individet janë përgjegjës/përgjegjëse për jetën e tyre. Ata/ato duhet të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre brenda normave që shoqëria ka vendosur.

• Përfshirja dhe integrimi.
• Respektimi i të drejtave dhe nevojave.
• Partneriteti: koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë/partneréee të tjerë/a në komunitet.
• Cilësia e shërbimeve.
• Standardet Kombëtare udhëheqin vendimmarrjen në nivel vendor

Plani Vendor i Veprimit për Mbrojtjen Sociale hartohet në përputhje:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
- Konventën për të Drejtat e Njeriut
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve
- Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara
- Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar)
- Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale
- Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH)
- Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,
- CEDAW

Dokumentet strategjike:

- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020
- ✓ Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030
- ✓ Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030
- ✓ Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020
- ✓ Dokumenti Politik – Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale
- ✓ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030
- ✓ Strategjia Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020-2023
- ✓ Plani Strategjik për Zhvillimin Institucional të Komitetit për Pakicat Kombëtare 2023 – 2026

Korniza e përgjithshme ligjore, mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social përbëhet nga:

- Ligji Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë",
- Ligji Nr.121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 104/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë",
- Ligji Nr.10107/2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë",
- Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
- Ligji Nr. 8137/1996 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane per mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (FZ 20-1996).
- Ligji Nr. 96/2017 "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë"

## PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MBROJTJEN SOCIALE 2025-2028

***Plani Vendor i Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028** ka gjithashtu, synimin të shërbejë si bazë për dialog të mëtejshëm me Qeverinë Shqiptare, Donatorë (ndërkombëtarë dhe kombëtarë) dhe partnerët socialë / shoqërinë civile mbi çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes sociale.*
*Bashkia Elbasan garanton një sistem integral të mbrotjes sociale nëpëmjet hartimit, miratimit të Planit Social 2025-2028, Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030, Planit të Integritetit 2025-2028, Planit për strehimin,Planit të Arsimit Parauniversitar etj. Të gjitha Planet janë pjesë integrale e sistemit të mbrojtjes sociale në Bashkinë Elbasan, ato janë gjithpërfshirës dhe komplimentarë të njërit- tjetrit duke ofruar një mbulim të integruar të shërbimeve përqytetaret/qytetarët,gratë/burrat,vajzat/djemtë,të rejat/të rinjtë dhe grupet vulnerabël "në të gjithë diversitetin e tyre"*

## KUADRI INSTITUCIONAL

### Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social Arsimit, Rinisë dhe Sporteve(DPKSARS)

DPKSARS ka për mision vënien në zbatim dhe mirë administrimin e politikave, legjislacionit dhe shërbimeve shoqërore për individët, familjet dhe grupet e ndryshme shoqërore brenda territorit të Bashkisë Elbasan. Ajo është përgjegjëse për identifikimin e individëve, familjeve dhe grupeve vulnerabël, hartëzimin e shërbimeve sociale si edhe hartëzimin e nevojave me qëllim planifikimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve cilësore në territorin e Bashkisë Elbasan.

### Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale
Sektori Për Mbrojtjen Gjinore, Diskriminimin dhe Etnitë
Sektori i Kujdesit të Shtresave në Nevojë, Moshës së Tretë dhe Pakicave Etnike
Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës
Sektori i Sportit, Rinisë, Migracionit dhe Diasporës
Sektori i Arsimit Parashkollor dhe Shëndetësisë

### *a.* Sektori i strehimit

Shërbimi Social në Bashkinë Elbasan është organizuar në një mënyrë për t'i dhënë përgjigje nevojave të territorit, të shpërndarjes së burimeve ekonomike që ka në dispozicion, si edhe vendosjes në rrjet të burimeve sociale dhe institucionale për të plotësuar nevojat e target-grupeve të ndryshme dhe sidomos atyre *vulnerabël "në të gjithë diversitetin e tyre"*

Ndër shërbimet e shumta që Bashkia ofron janë edhe Shërbimet Shoqërore që konsistojnë në formë të ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë, të shërbimeve të përkujdesit social, rezidencial dhe komunitar.

## PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MBROJTJEN SOCIALE 2025-2028

Për t'iu përgjigjur nevojave dhe stadit aktual, Shërbimi Social në Bashki ka si qëllim: krijimin e një vizioni dhe perspektive të re të sistemit të shërbimeve që shkon sa më pranë individit, familjes, komunitetit si dhe koordinimin e administrimit të burimeve në territor, duke iu përgjigjur kërkesave sociale.

Në politikat sociale që Bashkia ka, me mjaft vëmendje shihen proceset e decentralizimit për menaxhimin dhe mirëfunksionimin e shërbimeve sociale si dhe mbështetja e shërbimeve alternative, si qendrat komunitare, qendrat ditore etj., për të gjitha grupet në nevojë *"në të gjithë diversitetin e tyre"*

Prioritet i punës së bërë nga bashkia ka qenë mbrojtja dhe integrimi i fëmijëve në nevojë apo në risk dhe i viktimave të dhunës në familje. Sektori i mbrojtjes së fëmijëve dhe barazisë gjinore pranë Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale në bashki është struktura koordinuese e këtij procesi ku synohet mbështetja e fëmijëve dhe familjeve në risk dhe e viktimave të dhunës në familje deri në integrimin e plotë të tyre përmes menaxhimit të rasteve të identifikuara.

Sektori i Strehimit Social ka përgjegjësinë e mirëadministrimit të programeve që lidhen me strehimin e target-grupeve në nevojë, nëpërmjet përdorimit efiçent dhe efikas të burimeve financiare dhe njerëzore në dispozicion të saj.

Me qëllim arritjen e misionit dhe objektivave të DPKPS, ky **Plan Vendor i Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028** ka identifikuar dhe adresuar nevojat për ngritjen e kapaciteteve të stafit (punonjëse/punonjës) të bashkisë.

---

## 1. METODOLOGJIA E PËRDORUR

Metodologjia e ndjekur për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028 përfshin realizimin e desk review, fokus-grupeve, intervistave dhe konsultimeve. Procesi u realizua në tre faza:

1- Faza e parë: "Vlerësimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2020-2022"

1.1 Desk review: Një vështrim i plotë i politikave vendore lidhur me shpërndarjen e shërbimeve sociale. Inventarizimi i shërbimeve të ofruara nga bashkia dhe OJF që ofrojnë shërbime sociale në Bashkinë e Elbasanit. Grumbullimi i të dhënave të Bashkisë Elbasan për shërbimet sociale dhe grupet e targetuara "në të gjithë diversitetin e tyre"

Analizë social-ekonomike e Bashkisë Elbasan.

1.2 Pesë fokus-grupe u realizuan për të kuptuar arritjen e objektivave të Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2020-2022.

1.3 Vlerësimi i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2020-2022.

2- Faza e dytë: "Draftimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028"

2.1 Vlerësimi i kapaciteteve institucionale, materiale, financiare dhe njerëzore (punonjëse/punonjës) të bashkisë, për të ofruar shërbime sociale me standarde.

2.2 Konsultime për të kuptuar nevojat, problemet, interesat dhe sfidat për vitet e ardhshme për **Planin Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028** me:

i) strukturat kryesore të ofrimit të shërbimeve sociale në Bashkinë Elbasan;

ii) strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit vendor;
iii) përfaqësuese/përfaqësues të OJF-ve që ofrojnë shërbime për komunitetin.
2.3 Rishikimi i **Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028**, për Bashkinë e Elbasanit në nivel aktivitetesh.

**3- Faza e tretë: "Finalizimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028"**
3.1 Draftimi i **Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028.**
3.2 Konsultimi publik i **Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028** (web Bashkia Elbasan).
3.3 Përfshirja e komenteve dhe rekomandimeve në **Planin Vendor të Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2025-2028.**

# I. ANALIZA E SITUATËS

## 1.1 PROFILI I BASHKISË ELBASAN

***Shtrirja gjeografike dhe popullsia***, Bashkia Elbasan ka një sipërfaqe prej 872.03 km² dhe kufizohet në veri me Bashkinë Tiranë, në lindje me Bashkinë Librazhd, në jug-lindje me Bashkinë Prrenjas, në jug-perëndim me Bashkinë Gramsh dhe në perëndim me Bashkinë Peqin dhe Cërrik. Bashkia Elbasan është bashkia e tretë më e madhe në Shqipëri. Bashkia e Elbasanit është pjesë e Qarkut Elbasan. Ajo përbëhet nga qyteti, 12 Njësi Administrative (Labinot-Fushë, Labinot-Mal, Gjinar, Shushicë, Gjergjan, Funar, Shirgjan, Tregan, Gracen, Bradashesh, Papër, Zavalinë) dhe 116 fshatra.

| | **Njësitë administrative përbërëse** | **Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre** |
|---|---|---|
| **Bashkia Elbasan** | **Elbasan** | Qyteti Elbasan (6 Lagje) |
| | **Labinot-Fushë** | Fshatrat; Labinot-Fushë, Godolesh, Griqan i Sipërm, Griqan i Poshtem, Xibrakë, Mengel |
| | **Labinot-Mal** | Fshatrat; Labinot-Mal, Guri Zi, Sericë, Lamollë, Benë, Lugaxhi, Qafë, Qerret, Shmil, Dritas |
| | **Gjinar** | Fshatrat; Gjinar, Lleshan, Valesh, Pashtresh, Derstilë, Lukan, Sterstan, Xibresh, Maskarth, Kaferr, Pobrat |
| | **Shushicë** | Fshatrat; Shushicë, Shelcan, Mlizë, Hajdaran, Fush-Bull, Vasjan, Polis i Vogël, Polis Vale, Vreshtaj |
| | **Gjergjan** | Fshatrat; Gjergjan, Bujaras, Gjonmë, Keshtjellë, Kodër Bujaras, Muriqan, Thanë |
| | **Funar** | Fshatrat; Branesh, Bixëlle, Prec e Sipërme, Cerujë, Korrë, Mollagjesh, Krrabë e Vogël, Prec e Poshtme, Stafaj |

| | | |
|---|---|---|
| | **Shirgjan** | Fshatrat; Shirgjan, Bathes, Bujqës, Jagodinë, Kuqan, Kryezjarr, Mjekës |
| | **Tregan** | Fshatrat; Tregan, Blerimas, Bizhdan, Cikallesh, Gurisht, Kacivel, Kyçyk, Muçan, Shinavlash, Shilbater, Trepsenisht, Tudan |
| | **Gracen** | Fshatrat; Gracen, Plangaricë, Tërbaç, Bodin, Shingjin, Gjorm, Pajengë, Mamel, Dopaj |
| | **Bradashesh** | Fshatrat; Bradashesh, Balëz Lart, Balëz Poshtë, Kusarth, Kozan, Karakullak, Letan, Rrilë, Shtemaj, Ulën, Katund i Ri, Fikas, Petresh, Shëmhill, Shijon, Reçan, Gurabardh |
| | **Zavalinë** | Fshatrat; Zavalinë, Seltë, Kamiçan, Joronishtë, Nezhan, Burrishtë |
| | **Papër** | Fshatrat; Papër, Broshkë, Murras, Valas, Vidhas, Pajun, Bizhutë, Papër-Sallak, Vidhas-Hasgjel, Lugaj, Jatesh, Balldre, Ullishtaj |

Sipas të dhënave të INSTAT popullsia e Bashkisë Elbasan është 141.714 banorë me një dendësi prej 162.51 banorë/$km^2$ (Census, 2011). Ndërkohë, sipas regjistrit të gjendjes civile të Bashkisë Elbasan, popullsia e saj është 214,361 banorë me një dendësi prej 245.81 banorë/$km^2$.
Rreth 60 % e popullsisë së Bashkisë Elbasan jeton në qytet, nga të cilët 131,749 persona në zonat urbane dhe 82,612 në zonat rurale me një përfaqësim gjinor 49% femra dhe 51% meshkuj. Bashkia ka një numër total familjesh prej 70,194 nga të cilat 44,865 jetojnë në zonën urbane dhe 25,329 në pjesën rurale të Bashkisë Elbasan[2]. Mosha mediane e popullsisë është 37,1 vjeç.[3]
Niveli i papunësisë ( 15-29 vjç) në Bashkinë Elbasan në dhjetor 2022 është 21.5 % ose 2 herë më i lartë se niveli i papunësisë për të gjitha popullsinë aktive (10.8%)[4]
Ekonomia e Bashkisë Elbasan ndahet mes shërbimeve, tregtisë dhe industrisë në qytet dhe bujqësisë e blegtorisë në zonat rurale. Ajo ka në territorin e saj një pjesë të madhe të industrisë së rëndë të Shqipërisë, përfshirë industrinë e përpunimit të metaleve, atë të çimentos, ferrokromit, përpunimit të çimentos etj. Të dhënat e ofruara nga INSTAT, tregojnë se për vitin 2021 kjo bashki numëron 4557 ndërmarrje aktive, 30% e të cilave drejtohet nga gratë dhe vajzat . Krahasuar me vitin 2020 numri i ndërmarrjeve aktive për vitin 2021 është ulur me 22.6% . Bashkia Elbasan ka të zhvilluar një larmi sipërmarrjesh private të tilla si: Bujqësi dhe peshkim; Industri; Ndërtim; Tregti; Hoteleri, bare, restorante; Transport; dhe Shërbime të tjera.[5]

1 Sektori i Statistikave, Bashkia Elbasan.

[3] INSTAT, Vjetari Staistikor Rajonal, 2019, fq. 14. <http://ëëë.instat.gov.al/media/6466/vjetari-statistikor-rajonal-2019.pdf> [Aksesuar më 22 Dhjetor 2021]>

[4] Tabela 3. Anketa Tremujore e Forcave të Punës, Tr.4.2018-Tr.4.2022

[5] https://amvv.qeverisjavendore.gov.al/elbasan/

Bujqësia është e përqendruar në pjesën e territorit të fshatrave të Bashkisë. Të dhëna të ofruara nga INSTAT në fund të vitit 2021 numërohen 1651 fermere/ fermerë në Bashkinë Elbasan.

## 1.2 MBROJTJA SHOQERORE

Mbrojtja shoqërore dhe shërbimet e kujdesit social në Bashkinë Elbasan përbëhen nga tre programet në vijim:

1.2.1 Programi i Ndihmës Ekonomike

1.2.2 Pagesa për aftësinë e kufizuar

1.2.3 Shërbimet e kujdesit shoqëror

### 1.2.1 NDIHMA EKONOMIKE

Në kushtet kur në Shqipëri nuk ka bazë krahasimi për nivelin e varfërisë është pranuar fakti se ndihma ekonomike lehtëson varfërinë nëpërmjet skemës së NE.

Në Bashkinë Elbasan pagesa e Ndihmës Ekonomike është programi bazë i mbështetjes së familjes në nevojë. Që nga Janari 2018 në Bashkinë Elbasan (sikurse në të të gjithë territorin e Shqipërisë) ndihma ekonomike ofrohet sipas skemës së formulës së pikëzimit e cila ofron mundësinë që krahas familjeve të përzgjedhura përfituese të NE, Bashkia të ofrojë mbështetje edhe për familjet e varfëra dhe grupet e targetuara *"në të gjithë diversitetin e tyre"*, jo përfituese nga sistemi i pikëzimit, nëpërmjet përdorimit të fondit 6% të bashkive[6]. Burimi i financimit të NE në këto skema është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në të njëjtën kohë Bashkia Elbasan ofron nga burimet e veta një fond të veçantë për familje në nevojë të cilat nuk përfitojnë nga skemat e mësipërme duke përcaktuar paraprakisht me vendim të Këshillit Bashkiak kritere specifike përfituese. Pavarësisht skemave apo burimeve të financimit, përgjithësisht skema e përfitimit të ndihmës ekonomike në Bashkinë Elbasan paraqitet një skemë dinamike aktive.

Ajo që vërehet është së numri i familjeve përfituese të NE në vitin 2022 në krahasim me vitin 2019 është ulur në masën 16% ( 4784 familje përfituese në vitin 2022 kundrejt 5724 familjeve përfituese në vitin 2019). Është rritur me 0.77% fondi i Ndihmës Ekonomike në vitin 2022 (378.326 mijë lekë) në krahasim më vitin 2019 (375.427 mijë lekë). Po kështu është rritur edhe masa mesatare mujore e përfitimit të NE. Në vitin 2022 masa mesatare mujore e përfitimit të NE është rritur me 21% në krahasim me vitin 2019.

Numri i familjeve përfituese nëpërmjet përdorimit të fondit 6% është rritur me 61% ( 220 familje përfituese në 2022 kundrejt 137 familjeve përfituese në 2021). Fondi i Ndihmës Ekonomik është në rritje 138% , në vitin 2022 fondi i NE për këtë skemë është 9.879 mije lekë ndërsa në vitin 2019 ky fond kap vlerën 4.145 mijë lekë. Në vitin 2022 është rritur me 48% masa mesatare mujore e

[6] Këshilli Bashkiak trajton me ndihmë ekonomike familjet në nevojë të cilat nuk mund të përfitojnë NE nga skema e pikëzimit, duke vendosur kriteret e veta të trajtojnë familje që ato gjykojnë se janë të varfra, duke i dhënë një fond shtesë në masën 6 përqind mbi fondin për bllok-ndihmën ekonomike për Bashkinë.

përfitimit të NE sipas kësaj skeme ( 3742 lekë në muaj në vitin 2022 dhe 2521 lekë në muaj në 2019).

Numri i familjeve përfituese të NE me fondet e veta të Bashkisë Elbasan në 2022 në krahasim me 2019 është rritur me 55% ( 77 familje trajnohen në vit në 2019 dhe në fund të 2022 numërohen 110 familje). Edhe fondi i alokuar për këtë skemë ka një rritje prej 23% ( në vitin 2022 Bashkia alokon një fond vjetor 3.326 mijë lekë, në vitin 2019 fondi i alokuar është 2.733 mijë lekë). Masa e NE për këtë skemë është ulur, nga 3209 leke në muaj në vitin 2019 në 2543 lekë në muaj në vitin 2022. Kjo ulje lidhet me kriteret specifike të vendosura nga Këshilli Bashkiak i cili mbështet familjet me numër të vogël anëtarë që nuk arrijnë të përfitojnë nga skemat e tjera ( p.sh. prind i vetëm me max 2 fëmijë, të vetmuar të grupmoshës 55-64 vjeç të cilët nuk arrijnë të gjejnë punë dhe nuk kanë mundësi të përfitojnë shërbime rezidenciale etj.)Në vitin 2023 numri i familjeve përfituese të NE është 5472 familje dhe fondi i alokuar është38202545 ndërsa në vitin 2024 kemi 3634 familje dhe fondi me një fond prej 25139630, pra ka një ulje të numrit të familjeve në vitin 2024 me 33,575% krahasuar me vitin 2023.

Sa më sipër, evidentohet ulje e ndjeshme e familjeve përfituese të NE. Kjo ulje ka ardhur si pasojë e profesionalizmit të punës së administratorëve shoqërore duke parandaluar aplikimet dhe përfitimet abuzive, uljes së përfitimeve abuzive nga skema e vlerësimit të NE ( sistemi i pikëzimit dhe kryqëzimi i të dhënave me institucionet e tjera), zbatimit të Programit të Daljes nga skema e NE. Ky program ka si qëllim ndërlidhjen e programeve të mbrojtjes sociale me skema të tjera nxitëse punësimi, duke u krijuar mundësinë e integrimit në tregun e punës të anëtareve/ anëtarëve në moshë pune në skemën e NE. Programi i Daljes ka në fokus nxitjen e anëtareve/anëtarëve të aftë për punë të familjeve përfituese të NE drejt skemave të punësimit dhe formimit profesional. Bashkia Elbasan është një nga 3 bashkitë në nivel kombëtar që filloi që në vitin 2022 të zbatojë këtë program në bashkëpunim me DRSHSSH Elbasan dhe Zyrën e Punësimit dhe Aftësimit Elbasan. Në bazë të marrëveshjes 3 palëshe ( Bashki, DRSHSSH Elbasan dhe Zyrës për Punësim dhe Aftësim Elbasan),administratoret/ administratorët shoqërorë në lagjet dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan informuan, nxitën dhe orientuan anëtaret/ anëtarët madhorë të aftë për punë të familjeve përfituese të NE drejt skemave të punësimit dhe formimit profesional. 281 anëtare/anëtarë të familjeve përfituese të NE në qytetin e Elbasanit u punësuan dhe u larguan nga skema e NE-së për vitin 2022.

**Pjesë integrale e pagesës së NE janë subvencionet[7] shtesë të ofruara nga Bashkia Elbasan:**

- Për familjet me fëmijë të vegjël për vaksinimin dhe arsimimin e tyre në masën deri në 400 lekë shtesë aplikohen çdo muaj.
- Kompensim për rritjen e çmimit të energjisë elektrike. 2541 familje përfituan kompensim për rritjen e cmimit të energjisë elektrike në masën 40,084 mije lekë për vitin 2022.
- Ndihma Ekonomike krahas kategorive ekzistuese përfituese të transfertës së NE (familjeve në nevojë edhe jetimëve) mbështet edhe familjet me trinjakë, katërnjakë e pesënjakë; Aktualisht, vetëm një familje me mbi 3 trenjakë, përfitoi NE dhe masa e përfitimit është 9900 lekë në muaj.

[7] Ky subvencion përllogaritet shtesë në pagesën e NE

- Viktimat e trafikimit[8] dhe viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Numri i viktimave të trafikimit në Bashkinë Elbasan për vitin 2022 ishtë 2 raste dhe fondi për to ishtë 221 mijë lekë. Numri i viktimave të dhunës në Dhjetor 2022 në Bashkinë Elbasan është rritur me 39.08% në krahasim me janarin 2022. Për vitin 2022, janë mbështetur mesatarisht 75 viktima me një fond prej 8.830 mijë lekë.
- Duke filluar nga Janari 2019, Bashkia Elbasan, nëpërmjet politikave të reja sociale, mbështet drejtpërdrejt fëmijët, familjen dhe zhvillimin e shoqërisë, duke garantuar shpërblimin (bonus) për çdo të porsalindur, 40 mijë lekë për fëmijën e parë, 80 mijë lekë për fëmijën e dytë dhe 120 mijë lekë për fëmijën e tretë. Për vitin 2022, 2369 familje përfituan dhe vlera e lëvruar nga bashkia është 163.285 mijë lekë.

Krahas skemave mbështetëse në para të Ndihmës Ekonomike Bashkia Elbasan zbaton një politikë mbështetëse për familjet në nevojë *"në të gjithë diversitetin e tyre"* që lidhen me:

- Mbulimin e shpenzimeve të transportit për fëmijët për ndjekjen e arsimit të detyruar, për vitin 2022 vlera e fondit për mbulimin e transportit ofruar nga Bashkia Elbasan ështët 59.3 milion lekë;
- Ofrimi i paketës së ndihmës në natyrë;
- Ofrimi i lehtësirave për sigurimin e ngrohjes në periudhën e dimrit;
- Prioritizimit të familjeve në NE në skemat e strehimit nëpërmjet ofrimit të bonusit të qerase për shtëpi;
- Përjashtim apo ulje të detyrimit për taksat për familjet përfituese nga skemat e mbrotjes sociale në Bashki;

## *SFIDAT LIDHUR ME NDIHMËN EKONOMIKE*

Sfidat në lidhje me zbatimin e skemës së përfitimit të transfertave të NE janë:

- Zbatimi me efikasitet i skemës së NE në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan, vlerësimit të paraprak të familjeve që aplikojnë për NE nëpërmjet intervistimit dhe vizitave periodike në shtëpi të familjeve aplikuese apo përfituese të NE-së.

- Rritja e kapaciteteve të strukturave të Bashkisë Elbasan, në fusha që përfshijnë administrimin dhe monitorimin e skemës së Ndihmës Ekonomike.

- Zbatimi i "***Programit të Daljes***" duke u fokusuar tek anëtarët e aftë për punë të familjeve që kanë mbi 5 vite që përfitojnë pagesë të NE-së, duke i integruar ato në tregun e punës dhe jetën shoqërore.

[8]Neni 1 ligjit nr.10 252, datë 11.3.2010

- Promovimi i ndërmarrjeve sociale një model drejt skemave të financimit të aktiviteteve që synojnë integrimin në punë të anëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese të NE-së.

- Integrimi i shërbimeve ndaj përfituesve të Ndihmës Ekonomike me shërbime shoqërore, ndihma ekonomike në natyrë (bonuse), arsim, strehim apo tjetër, parë në këndvështrimin e familjes, si shërbim i integruar, bazuar në qasjen e ciklit të jetës (fëmijë/të rejat/ të rinjtë/ të moshuar).

- Ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi të opinionit publik dhe grupeve të interesit, për të komunikuar në mënyrë të shenjëstruar, se kush janë qëllimet reale dhe rezultatet e pritshme të planit.

### 1.2.2 AFTËSIA E KUFIZUAR

Sipas statistikave Bashkia Elbasan, në dhjetor 2022 numri i personave(gra/burra, vajza/djem,të reja/të rinj)që janë njohur zyrtarisht që kanë një aftësi të kufizuar në Bashki është 11990 ( 5.6 % e popullsisë së bashkisë). Nga këta, 5932 persona janë invalidë pune që përfitojnë si nga pagesat e sigurimeve shoqërore ashtu edhe nga pagesat shtesë të skemës së mbrojtjes sociale dhe 6058 fëmijë e të rritura/të rritur, që marrin pagesat e aftësisë së kufizuar dhe përfitime të tjera në sistemin e mbrojtjes sociale. Nga këta të fundit, 813 persona (13.4%) marrin edhe pagesë për të mbuluar shërbimin e ndihmëses/ndihmësit personal që më parë është quajtur shërbimi i kujdestarisë.

Sipas nenit 8 të ligjit [9]përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:

a) personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe mosha;

b) personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

*c)* personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar;

ç) personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës

Gjithashtu përfitojnë pagesë verbërie të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshëm të shikimit, të lindur ose të fituar të cilët sipas kritereve mjekësore janë të paaftë për punë dhe sipas përcaktimeve të ligjit nr.8098 date 28.03.1996 "Për Statusin e të Verbërit", si dhe VKM nr.277 date 18.6.1997 "Per perfitimet nga statusi i te verberit".

[9] Ligji nr. 57/2019, "për asistencën sociale në RSH"

Në vitin 2021 në Bashkinë Elbasan nisi të zbatohej Modeli Bio-psiko-social për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar. Me modelin e ri, përfitimi i aftësisë së kufizuar ofrohet për katër nivele (niveli i lehtë i AK, nivel mesatar i AK, nivel i rëndë i AK dhe nivel i thellë i AK), nga dy nivele të kategorizuara në modelin e vjetër (grupi i parë dhe grupi i dytë).

Kjo ndarje në katër nivele synon nxitjen dhe integrimin në jetën shoqërore, si gjithë të tjerët, të personave/personave me AK që kanë dëshirë dhe mundësi të kenë një jetesë të pavarur. Ligji parashikon që personat/personet me AK të vlerësuar/a në nivelin e lehtë të orientohen drejt shërbimeve, formimit profesional dhe punësimit.

Gjithashtu, në modelin e ri **Ndihmësja personale/ndihmësi personal** është konceptuar/e si një mbështetje e individes/individit për të kryer aktivitetet bazike të jetesës në momentet kur individi paraqet nevojë për mbështetje. Në këtë mënyrë, ndihmësja personale/ndihmësi personal mund të jetë e/i herëpashershm (vetëm në rastet kur personit me AK i nevojitet të kryejë aktivitete bazike të përditshme) ose ndihmësja personale/ndihmësi personal e/i përhershm (që qëndron pranë personit me AK në çdo moment të jetës së saj/të tij për të kryer veprimtari të përditshme).

Nga njëra anë, sistemi i ri i vlerësimit paraqet një reflektim të praktikës bashkëkohore ndërkombëtare duke rritur eficiencën e procesit; nga ana tjetër, ka ulur ndjeshëm përfitimet abuzive. Në vitin 2022 numri i personave përfituese/përfitues të AK është ulur me 5.06% (në vitin 2022 trajtohen mesatarisht në muaj 5703 persona/persona me AK kundrejt 6007 personave/personave të trajtuar/a në vitin 2021).

Numri i personave përfituese/përfitues të ndihmëses personale/ndihmësit personal gjatë vitit 2022 është ulur në masën 15.39% në krahasim me vitin 2021 (në vitin 2022 trajtohen mesatarisht 863 persona me ndihmëse personale/ndihmës personal kundrejt 1020 personave përfituese/përfitues në vitin 2021).

Fondi i përfituar për aftësinë e kufizuar në vitin 2022 është ulur me 45.6% në krahasim me vitin 2021. Kjo ulje tregon jo vetëm largimin nga skema e vlerësimit të përfituesve/ve abuzivë/e, por edhe rivlerësimin e nivelit të aftësisë së kufizuar, të shoqëruar me ndryshim të masës së përfitimit.

Ndërsa vlerësimi i aftësisë së kufizuar me modelin social realizohet nga Komisionet Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, të ngritura pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, roli i Bashkisë në këtë proces orientohet drejt:
i) zbatimit të rekomandimeve të komisionit shumëdisiplinar për hartimin e planeve zhvillimore njëvjeçare për personat/personet me aftësi të kufizuara dhe ndjekjen e tyre;
ii) vlerësimit të përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar nëpërmjet verifikimit të cilësisë së kushteve të jetesës së personit/persones me aftësi të kufizuara çdo tre muaj (pra 4 herë në vit).

Burimet njerëzore (punëtore/punëtorë) të Bashkisë Elbasan për zbatimin e detyrave funksionale ligjore për AK aktualisht janë të pamjaftueshme.

SFIDAT LIDHUR ME AFTËSINË E KUFIZUAR

Sfidat e Bashkisë Elbasan në zbatimin e politikave për aftësinë e kufizuar lidhen me:

1. Mundësinë për ofrimin e shërbimeve shoqërore për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, të vlerësuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar, për të përfituar shërbime të përshtatshme shoqërore;
2. Institucionalizimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel vendor për mbështetjen dhe trajtimin e personave me aftësi të kufizuara, sipas rekomandimeve të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;
3. Rritjen e kapaciteteve të stafit të Bashkisë (administratoreve dhe administratorëve shoqërorë në lagje dhe njësitë administrative) për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve zhvillimore vjetore për personat me aftësi të kufizuara;
4. Sigurimin e kushteve të përshtatshme të punës për administratoret dhe administratorët shoqërorë, në funksion të zbatimit të kërkesave ligjore për ndjekjen dhe monitorimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, përmes verifikimit të drejtpërdrejtë në banesë.

### 1.2.3 SHËRBIMET SHOQËRORE

Programi i tretë i mbrojtjes sociale në Bashkinë Elbasan është zhvillimi i shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror.

"Shërbime të kujdesit shoqëror", sipas Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", janë një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësirash, të cilat ofrohen nga profesioniste dhe profesionistë të fushave përkatëse, të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve dhe familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si një shportë minimale shërbimesh me bazë komunitare, strehëza të përkujdesit shoqëror, si dhe shërbime asistence në familje për të gjitha kategoritë e identifikuara të përfituesve.

Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe Pakti Social ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Elbasan, sanksionojnë që Bashkia të ndërtojë shërbimet bazë të shportës së shërbimeve shoqërore, të cilat përfshijnë pothuajse të gjitha llojet e shërbimeve të përcaktuara në ligj.

Bashkia Elbasan realizon shportën e saj të shërbimeve shoqërore në bazë të planeve sociale, të hartuara nga profesioniste dhe profesionistë, në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë dhe aktorë lokalë. Organizatat jofitimprurëse që veprojnë në territorin e Bashkisë Elbasan luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve sociale. Megjithatë, ato përballen me vështirësi në sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve, pasi në pjesën më të madhe varen nga fondet e donatorëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë.

Aktualisht, në qytetin e Elbasanit janë ngritur dhe funksionojnë 21 qendra, të cilat ofrojnë të gjitha llojet e shërbimeve të përcaktuara në ligj për të gjitha kategoritë në nevojë. Qendrat janë të ndarë sipas burimit të financimit, si më poshtë:

- 3 qendra janë publike dhe financohen nga Bashkia Elbasan;
- 6 qendra financohen nga një kombinim burimesh: Bashkia, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (ku 2 prej tyre mbështeten nga Fondi Social) dhe organizatat jofitimprurëse;
- 12 qendra financohen ekskluzivisht nga donatorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë.

Kapaciteti i këtyre qendrave është i kufizuar dhe nuk mbulon plotësisht të gjitha nevojat për shërbime shoqërore në nivel bashkie. Shërbimet komunitare janë të lokalizuara kryesisht në qytetin e Elbasanit dhe në rrethinat e tij.

Vetëm në 1 (një) nga 12 Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan është ngritur dhe funksionon një qendër komunitare. Kjo qendër financohet nga Bashkia me fondet e veta dhe ofron shërbime për komunitetin lokal të zonës përkatëse.

---

Tabela 1: Qendrat që ofrojnë shërbime shoqërore në Bashkinë Elbasan sipas burimit të financimit

| Nr | Institucioni | Lloji | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Publik | Jo-Publik | I përzier | Qeveria | Qarku | Bashkia | OJF/ Org Nderk/FOndacion/Mix |
| 1 | Qendra Sociale "Balashe" | x | | | X | | X | |
| 2 | Qendra "Fluturo per Jeten" | x | | | X | | | |
| 3 | Shkolla speciale "Zera Jete" | x | | | X | | X | |
| 4 | Qendra "Future for You" | | x | | | | | |
| 5 | Qendra Shqiptare per Integrimin e | | x | | | | | x |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Njerezve me Nevoja te Vecanta | | | | | | | |
| 6 | Shoqata per sherbime psiko sociale të dëgjoj 366 | | x | | | | | x |
| 7 | Shoqata e të verbërve | | x | | | | | x |
| 8 | Shoqata e para e tetraplegjikëve | | x | | | | | x |
| 9 | Studio psikoterapie serendis terapi | | x | | | | | x |
| 10 | Qendra Komunitare Rome | | x | | | | | x |
| 11 | Qendra Ditore "Buka e jetës A2B" | | x | | | | | x |
| 12 | Qendra Komunitare multidisiplinare shushice | X | | X | X | | X | |
| 13 | Qender Komunitare Multifunksional e | X | | X | X | | X | |
| 14 | Qendra e Gruas per Zhvillim dhe Kulture | | x | | | | | x |
| 15 | Forumi i Gruas Elbasan FGE | | | X | | | X | x |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | Fondacioni Joselyn | | X | | | | | x |
| 17 | Tjeter Vision | | | X | | | X | x |
| 18 | Ndihma e Ëeilheim per Shqipërinë | | X | | | | | |
| 19 | Misionaret e bamirësisë Motrat e Nënë terezës Elbasan | | x | | | | | x |
| 20 | Shtepia e mundesive | | | X | | | X | x |
| 21 | Qendra komunitare Adra Albania | | | X | | | | x |

Gjatë viteve 2020–2022, Bashkia Elbasan ka arritur të ofrojë të gjitha shërbimet e përcaktuara në shportën e shërbimeve shoqërore (shih Tabelën 2). Të gjitha qendrat ofrojnë shërbime parashoqërore për përfitueset dhe përfituesit përpara ofrimit të shërbimit përkatës.

Shërbimet shoqërore në Bashkinë Elbasan janë përqendruar kryesisht në:

- shërbimet komunitare,
- shërbimet ditore,
- shërbimet e specializuara
- shërbimi në familje.

Në Bashkinë Elbasan mungon aktualisht një qendër emergjence, megjithatë nevojat për këtë kategori shërbimi janë mbuluar përmes qendrave që ofrojnë shërbime rezidenciale, ndonëse këto të fundit kanë një tipologji tjetër të ndërhyrjes dhe ofrimit të kujdesit.

Tabela 2 Shërbimet e ofruara në qendrat publike dhe jo publike në Bashkinë Elbasan

| | Shërbime parashoqë | Shërbime rezidencia | Shërbime në | Shërbime komunitar | Shërbime në qendër | Shërbime në qendër | Shërbime në familje. | Shërbime të | Shërbime këshillimi | Shërbime në situatë | Shërbime të kujdesit alternativ |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | |
| Numri i qendra publik&jo publik qe ofrojnë shërbimin | 21 | 5 | 2 | 15 | 6 | 14 | 9 | 10 | 4 | 8 | 3 |

Në Bashkinë Elbasan përfitojnë shërbime shoqërore gjithsej 1,128 persona.
Ndër këta:

- 345 janë fëmijë,
- 249 janë fëmijë me aftësi të kufizuara,
- 44 janë të rinj e të reja në nevojë,
- 61 janë të rritur me aftësi të kufizuara,
- 144 janë gra dhe vajza,
- 193 janë të moshuar ose të moshuara.

Gjithashtu, ofrohet ndihmë direkte për 156 familje në nevojë, nga të cilat 76 kanë kryefamiljare gra.

Tabela 3 Tabela analitike e kategorive përfituese për shërbimet e ofruara Publik/Jo publik

| Kategoritë Përfituese | Përfitues total | Të ndarë sipas gjinisë | | Të ndarë në % sipas gjinisë | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Gra dhe vajza | Burra dhe djem | Gra dhe vajza | Burra dhe djem |
| Fëmijët në nevojë | 345 | 203 | 142 | 59% | 41% |
| Fëmijë me AK | 249 | 117 | 132 | 47% | 53% |
| Të rinj në nevojë | 44 | 10 | 34 | 23% | 77% |
| Të rritur me Ak | 61 | 16 | 45 | 26% | 74% |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Gra dhe vajza në nevojë | 144 | 144 | 0 | 100% | 0% |
| Të moshuar në nevojë | 193 | 81 | 112 | 42% | 58% |
| Familje në nevojë | 156 | 76 | 80 | 49% | 51% |

Të dhënat në Tabelën 3 prezantojnë shërbime të fokusuara kryesisht në territorin e qytetit të Bashkisë Elbasan dhe rrethinat e tij. Shërbimet shoqërore në njësitë administrative mungojnë. Me mbështetjen e organizatës Ëorld Vision, gjatë viteve 2020–2021 u realizuan shërbime shoqërore lëvizëse, duke ofruar mbështetje në zonat rurale të bashkisë. Ky shërbim u ndërpre në vitin 2022. Bashkia Elbasan synon vazhdimin e shërbimeve të këtij lloji përmes aplikimeve në Fondin Social. Fondi i alokuar nga buxheti vendor i bashkisë vetëm për shërbime shoqërore është mesatarisht 1,991,382 mijë lekë në vit. Gjatë dy viteve të fundit, Bashkia, në bashkëpunim me organizata jofitimprurëse lokale, ka arritur të ngrejë shërbime shoqërore të reja dhe të konsolidojë ato ekzistuese, përmes aplikimit dhe përfitimit të fondeve nga "Fondi Social" i mundësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si edhe përmes bashkëpunimit me partnerë dhe donatorë kombëtarë e ndërkombëtarë. Financimi i kufizuar nga fondet publike për shërbimet e kujdesit shoqëror paraqet një risk serioz për qëndrueshmërinë dhe mbulimin e tyre.

Me Vendimin nr. 1136, datë 24.10.2022 të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, në zbatim të Ligjit "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", është ngritur Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve (NJVNR) në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Elbasan (në total 18 njësi).

Në përbërje të NJVNR-ve është përfshirë:

- një Punonjëse/Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) – një nga punonjëset/punonjësit e zyrës, me ndalesë në njësinë administrative, merr këtë funksion përkatës;
- një Punonjëse/Punonjës Social – administratori/administratorja shoqërore i/e njësisë, krahas detyrave të tjera, ushtron edhe funksionin e punonjëses/ e punonjësit sociale për njësinë administrative.

Aktualisht, po punohet për riorganizimin dhe rritjen e kapaciteteve të NJVNR-ve, me fokus në qartësimin e rolit, detyrave dhe përgjegjësive të PMF-ve në procesin e menaxhimit të rasteve në nivel njësie administrative.

Vendosja e Punonjëses/Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) në çdo njësi administrative synon përmirësimin e shërbimit ndaj të miturve në rrezik, duke u fokusuar në:

- parandalimin e situatave të padëshiruara,

- evidentimin e rasteve,

menaxhimin, trajtimin dhe monitorimin e tyre në territor, përmes ngritjes së grupeve teknike të menaxhimit të rasteve në kohë reale, në bashkëpunim me aktorët lokalë dhe pranë vetë të miturve.
Përveçse një kërkesë ligjore, emërimi i PMF-së në çdo njësi administrative:

- lehtëson kostot e trajtimit të rasteve nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) që operon në Bashkinë Elbasan,
- forcon mekanizmat e parandalimit,
- mundëson reagim të shpejtë ndaj rasteve të neglizhencës, dhunës, abuzimit dhe formave të tjera të rrezikut për fëmijët.

Mirëfunksionimi i ligjit, rritja e problematikave sociale, përmirësimi i përgjegjshmërisë së institucioneve në adresimin e rasteve të fëmijëve në rrezik (përmes GTM-ve / tavolinave teknike etj.), si dhe shtimi i rasteve të raportuara nga vetë fëmijët, kanë çuar në rritje të ndjeshme të menaxhimit të rasteve.

- Në vitin 2019 u trajtuan 102 raste në total, ndërsa
- vetëm në periudhën Janar–Prill 2024, NJMF në Bashkinë Elbasan ka raportuar 68 raste të reja të menaxhimit për fëmijë në rrezik.

---

Me Vendimin nr. 703, datë 27.06.2022 të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, në zbatim të Ligjit "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", është ngritur dhe funksionon Sektori i Monitorimit të Shërbimeve Shoqërore.
Sektori përbëhet nga një staf prej 3 personash: 1 përgjegjëse/përgjegjës dhe 2 specialiste/specialistë.
Aktualisht po punohet për:

- hartimin e protokolleve të monitorimit, si dhe
- rritjen e kapaciteteve të stafit të sektorit.

## SFIDAT LIDHUR ME SHËRBIMET SHOQËRORE

Shërbimet shoqërore të ofruara nga Bashkia Elbasan nuk arrijnë të mbulojnë të gjitha nevojat e komunitetit.
Ato nuk sigurojnë ende:

- mbulim të plotë territorial,
- garanci për cilësi dhe qëndrueshmëri,

- burime financiare të qëndrueshme,
- prokurim të rregullt të shërbimeve,
- struktura dhe kapacitete vendore të afta për të vlerësuar nevojat, planifikuar, ofruar dhe monitoruar shërbimet në nivel lokal.

---

Sfidat kryesore të Bashkisë Elbasan për krijimin e një sistemi funksional dhe të integruar të kujdesit shoqëror janë:

1. Aftësimi i strukturave të Bashkisë për hartimin dhe miratimin e planeve sociale të shërbimeve shoqërore të kostuara për të gjitha njësitë administrative, si dhe prokurimin dhe kontraktimin e OJF-ve dhe sektorit privat për ofrimin e shërbimeve.

2. Ngritja e shërbimeve të reja dhe zgjerimi i shërbimeve ekzistuese për kategoritë në nevojë.

3. Ofrimi i shërbimeve komunitare në njësitë administrative përmes ngritjes dhe funksionimit të shërbimeve komunitare lëvizëse.

4.Riorganizimi i Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në të gjitha njësitë administrative, në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues.

Riorganizimi dhe fuqizimi i shërbimeve monitoruese, si një strukturë kyçe për garantimin e cilësisë së shërbimeve sociale për fëmijët, individët dhe familjet në nevojë.

---

II. ARRITJET DHE VËSHTIRËSITË NGA ZBATIMI I PLANIT SOCIAL 2020–2022

Bashkia Elbasan e realizon programin social në bazë të planeve sociale të përgatitura nga profesionistë, në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë dhe aktorë lokalë. Konkretisht, Plani Social 2020–2022 është hartuar nga Bashkia Elbasan me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, duke ruajtur pronësinë lokale.

Megjithëse në procesin e hartimit ka pasur pjesëmarrje të gjerë të stafit të bashkisë, gjatë zbatimit të tij janë hasur një sërë sfidash.

---

Sfidat kryesore lidhen me:

- Financimin e pamjaftueshëm,
- Kapacitetet e kufizuara profesionale të strukturave të bashkisë për sigurimin e shërbimeve të kujdesit social, përfshirë:

i) prokurimin e shërbimeve shoqërore;
ii) kontraktimin e ofruesve të shërbimeve;
iii) aftësinë për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave për shërbime sociale në territorin e bashkisë;
iv) shtrirjen e shërbimeve shoqërore në zonat rurale.

Monitorimi i zbatimit të Planit Social 2020–2022 u realizua përmes:

- organizimit të 5 (pesë) fokus-grupeve me aktorët lokalë,
- konsultimeve me profesionistët/profesionistet e Bashkisë Elbasan,
- analizës së të dhënave dhe informacionit të mbledhur nga vetë bashkia.

---

Nga analiza rezultoi se:

- një pjesë e aktiviteteve të përcaktuara në Planin Social 2020–2022 janë realizuar plotësisht,
- një pjesë janë realizuar pjesërisht, dhe
- një pjesë nuk janë zbatuar.

Niveli i zbatimit të aktiviteteve pasqyron edhe nivelin e arritjes së objektivave dhe qëllimeve të përcaktuara në Planin Social 2020–2022.

Aktivitetet që nuk janë realizuar ose janë realizuar vetëm pjesërisht në të tre qëllimet strategjike janë ndikuar nga një sërë faktorësh, si:

i) pandemia COVID-19 gjatë viteve 2020–2021;

ii) fokusimi i donatorëve dhe i Bashkisë Elbasan në përballimin e nevojave emergjente gjatë pandemisë, çka uli mundësinë për të zbatuar komponentë të tjerë të planit gjatë periudhës 2020–2021;

iii) struktura organizative e Drejtorisë së Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Elbasan, e cila rezulton e papërshtatshme për zbatimin dhe monitorimin e Planit Social;

iv) përshkrimet e punës së stafit të drejtorisë, të cilat nuk janë të orientuara drejt ofrimit të shërbimeve sociale;

v) burimet njerëzore të kufizuara në Drejtorinë e Shërbimeve Shoqërore;

vi) krijimi i strukturave të reja në njësitë administrative mbi burimet ekzistuese njerëzore, pa shtesë të stafit;

vii) mungesa e treguesve të qartë për vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Social 2020–2022.

Në vijim prezantohen aktivitetet e realizuara për secilin Qëllim Specifik të Planit Social 2020–2022:

Qëllimi Nr. 1: "Zbutja e varfërisë"

Nga 22 aktivitetet e planifikuara, janë realizuar:

i) Ngritja e Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN) pranë Njësive Administrative (NJA) dhe lagjeve të Bashkisë Elbasan;
ii) Zhvillimi i përshkrimeve të punës për stafin e NJVRN;
iii) Ngritja e Njësisë Monitoruese për monitorimin e shërbimeve sociale të ofruara në territorin e Bashkisë Elbasan;
iv) Koordinimi me strukturat përgjegjëse për punësimin e familjeve pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike (NE);
v) Integrimi në skema për nxitjen e punësimit;
vi) Shtimi i shërbimeve dhe monitorimi i strukturave të shërbimit social në bashki për plotësimin e nevojave të popullatës.

Qëllimi Nr. 2: "Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara"
Nga 32 aktivitetet e planifikuara janë realizuar:
i) Ofrimi i shërbimit ditor të përkujdesjes për personat që janë në gjendje të rënduar fiziko-mendore, duke u bazuar në standardet ligjore;
ii) Shërbim lëvizës për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara (AK) në familje sipas shërbimeve (funksional deri në vitin 2021);
iii) Mbështetje psiko-sociale për personat me AK dhe familjet e tyre;
iv) Trajnim i vazhdueshëm i punonjësve socialë dhe shëndetësorë mbi mënyrën e trajtimit të personave me aftësi të kufizuara (PAK);
v) Takime informuese për të shqyrtuar mundësitë e integrimit në punë të personave me aftësi të kufizuara (PAK);
vi) Ofrimi i trajnimeve dhe informimi për stafet përgjegjëse të pushtetit vendor për të rritur kapacitetet e tyre profesionale në shërbim të PAK;
vii) Realizimi i takimeve periodike mujore me stafet përgjegjëse të pushtetit vendor dhe organizatat e shoqërisë civile;
viii) Sesione dëgjimi për të marrë mendimet e personave me aftësi të kufizuara;
ix) Sesione ndërgjegjësimi për komunitetin e bashkisë dhe njësive vendore për PAK dhe raportimin e abuzimeve të ndryshme;
x) Mbledhje e rregullt e tavolinave multidisiplinare për personat me aftësi të kufizuara (AK).

Qëllimi Nr. 3: "Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social për fëmijët, gratë dhe moshën e tretë"
Nga 40 aktivitetet e planifikuara janë realizuar:
i) Rritja e kapaciteteve profesionale për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore;
ii) Organizimi i takimeve nga specialistët e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror (SHKSK) në Bashki për vlerësimin e nevojave të qendrave që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror;
iii) Ngritja e qendrave multidisiplinare pranë Njësive Administrative;
iv) Promovimi i modeleve të reja të shërbimeve sociale përmes organizimit të tryezave të rrumbullakëta;
v) Organizimi i takimeve me përfaqësues të biznesit dhe organizatave jo-fitimprurëse (OJF) për rritjen e fondeve për shërbime shoqërore;

vi) Mirëfunksionimi i shërbimeve të ofruara nga qendrat publike për kategoritë në nevojë;
vii) Ngritja e shërbimeve këshilluese dhe ndihmuese për përdoruesit e shërbimeve shoqërore;
viii) Trajnimi i përdoruesve të shërbimeve të kujdesit social për integrim në jetën sociale dhe ekonomike dhe për nxitjen e pavarësisë së tyre;
ix) Ngritja e një qendre polivalente në nivel vendor me kapacitet për 10 persona;
x) Trajnimi i vazhdueshëm i profesionistëve dhe strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve;
xi) Ngritja dhe pajisja e një qendre emergjence me të gjitha standardet e kërkuara;
xii) Ngritja e qendrave komunitare për fëmijët;
xiii) Ofrimi i shërbimeve këshilluese dhe riintegruese për të miturit në konflikt me ligjin;
xiv) Shtimi i shërbimeve të specializuara për fëmijët në nevojë;
xv) Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese;
xvi) Përmirësimi dhe zgjerimi i cilësisë së shërbimeve që ofrohen nga Qendra Sociale "Balashe";
xvii) Ofrimi i shërbimeve të specializuara pranë Qendrës Sociale "Balashe" për moshën e tretë.

Rekomandimet nga fokus grupet dhe konsultimet me aktorët lokalë për Planin Social 2025-2028:

- Qëllimet strategjike dhe specifike të planit të rishikuar do të riformulohen, duke ruajtur përmbajtjen dhe drejtimin kryesor të tyre.
- Aktivitetet që nuk u realizuan në periudhën 2024-2025 do të rishikohen dhe do të përfshihen në Planin e Veprimit 2025-2028, me përcaktimin e treguesve dhe afateve të qarta të zbatimit për secilin aktivitet.
- Aktivitetet e parealizuara të planit 2024-2025, të cilat nuk janë në kompetencë dhe funksion të Bashkisë Elbasan, nuk do të përfshihen në planin e rishikuar 2025-2028.

## III. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

### 3.1 VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Vizioni:

Garantimi i përfshirjes sociale për të gjithë banorët dhe banoret e territorit të Bashkisë Elbasan. Zhvillimi i mundësive dhe ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror cilësore, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e përjashtimit social për të gjithë, pa dallim të ardhurash, origjine, moshe, gjinie, etnie, edukimi, orientimi seksual, identiteti kulturor, apo bindjeve politike dhe fetare.

Objektivat Strategjikë:

I. Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë në Bashkinë Elbasan, duke siguruar mbulimin më të mirë të familjeve, fëmijëve dhe individëve në situatë varfërie ose varfëri ekstreme.

II. Zhvillimi i personave me aftësi të kufizuar, duke integruar skemën e pagesave në para me shërbime të integruara, për të mundësuar integrimin e tyre në jetën shoqërore dhe ekonomike.

III. Ofrimi i shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror, me standarde të përcaktuara, për të gjitha kategoritë në nevojë në gjithë territorin e Bashkisë Elbasan, për burrat, gratë, djemtë dhe vajzat.

IV. Fuqizimi, riorganizimi dhe koordinimi i shërbimeve sociale në nivel bashkie, për një menaxhim më efektiv dhe të qëndrueshëm të shërbimeve sociale, duke siguruar përfshirjen dhe trajtimin e barabartë të të gjithë banorëve dhe banoreve.

## 3.2 OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Objektivat specifike të Planit të Mbrojtjes Sociale 2024-2026 identifikohen si më poshtë:

A. Ulja e varfërisë nëpërmjet rritjes së efektivitetit të skemës së Ndihmës Ekonomike (NE)

Aktivitetet për realizimin e këtij objektivi janë:

A1. Rritja e efikasitetit të skemave të Ndihmës Ekonomike nëpërmjet shënjestrimit të familjeve ekstremisht të varfra, duke siguruar trajtim të barabartë për të gjitha gratë, burrat, vajzat dhe djemtë.

A2. Fuqizimi ekonomik i grupeve të disavantazhuara, përfshirë gratë dhe burrat, nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim dhe integrim socio-ekonomik përmes zbatimit të Programit të daljes nga skema e NE.

A3. Mbështetje e individëve dhe familjeve vulnerabël nga skemat e tjera mbështetëse të ofruara nga Bashkia, duke u fokusuar në nevojat specifike të të gjitha gjinive.

A4. Ndërgjegjësimi i publikut, grupeve të interesit dhe aktorëve të përfshirë në zbatimin e skemës së përfitimit të NE, përmes fushatave të komunikimit dhe informimit me qasje gjinore dhe përfshirëse.

B. Përfitimi për Aftësinë e Kufizuar dhe Integrimi me Shërbime Shoqërore për Personat me Aftësi të Kufizuar

Aktivitetet për realizimin e këtij objektivi janë:

B.1 Rritja e efikasitetit të mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara, duke adresuar nevojat specifike të grave, burrave, vajzave dhe djemve me aftësi të kufizuar.

B.2 Fuqizimi ekonomik i personave me aftësi të kufizuar, duke krijuar mundësi për përfshirje sociale dhe ekonomike të barabartë për të gjitha gjinive.

B.3 Sigurimi që personat me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre përfitojnë shërbime nga skemat e tjera mbështetëse të Bashkisë Elbasan, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave gjinore.

B.4 Ndërgjegjësimi i publikut, grupeve të interesit dhe aktorëve të përfshirë në zbatimin e reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar, përmes fushatave të komunikimit dhe informimit që synojnë përfshirje dhe barazi gjinore.

C. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale.

Aktivitetet për realizimin e objektivit janë:

C.1 Zgjerimi i shportës së shërbimeve shoqërore (për fëmijët dhe fëmijët e mitur, personat me aftësi të kufizuar, personat e moshuar etj.) duke ofruar një paketë të integruar shërbimesh për familjet dhe individët në nevojë, me vëmendje të veçantë ndaj vajzave, djemve, grave dhe burrave me nevoja të ndryshme.

C.2 Konsolidimi i sistemit të integruar të shërbimeve ekzistuese për fëmijët dhe fëmijët e mitur, personat me aftësi të kufizuar dhe personat e moshuar, duke krijuar një sistem shërbimesh integruese që kombinon shërbimet e kujdesit shoqëror me pagesat në para, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe gjinore.

D. Kapacitetet njerëzore dhe financiare të Bashkisë që i përgjigjen nevojave për shërbime shoqërore të integruara për të gjitha kategoritë në nevojë.

Aktivitetet për realizimin e objektivit janë:

D.1 Riorganizimi i Sektorit të Mbrojtjes dhe Kujdesit Shoqëror (Ndihma Ekonomike), duke marrë parasysh nevojat e të gjitha grupeve gjinore.

D.2 Riorganizimi i Sektorit të Kujdesit për Shtresat në Nevojë dhe Moshën e Tretë, duke siguruar përfshirjen e grave, burrave dhe grupeve të ndryshme.

D.3 Riorganizimi i Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në çdo njësi administrative, duke përfshirë përfaqësuesit dhe përfaqësueset nga komunitetet lokale.

D.4 Fuqizimi i strukturës së monitorimit të cilësisë së shërbimeve shoqërore në nivel lokal, me fokus në trajtimin gjinor dhe barazinë sociale.

## II PLANI I ZBATIMIT, MATRICA

| Objektivat | | Indikatori | Afati i zbatimit | | Institucionet përgjegjëse | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Afati i fillimit | Afati i mbarimit | Drejtoria/Sektori/Departamenti(Udheheqes) | institucion kontribues (nese ka) |
| **Objektivi Strategjik: Zbutja dhe lehtësimi e varfërisë në Bashkinë Elbasan duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve, fëmijëve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër.**<br><br>**Objektivi Specifik : A. Ulja e varfërisë nëpërmjet rritjes së efektivitetit të skemës së NE** | | | | | | |
| ***A 1 Rritja e efikasitetit së skemave së Ndihmës Ekonomike nëpërmjet shënjestrimit të familjeve ekstremisht te varfra*** | A1.1 Vlerësimi i nevojave të familjeve në nevojë përfituese ose jo të NE | Databaze me të dhënat e familjeve në nevojë është ngritur | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | |
| | A1.2 Mbështetje sa më e plotë e familjeve në nevojë përmjet ofrimitt të NE | Mbi 80 % e familjeve aplikuese te NE, vlersohen përfituese të NE-së | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | SHSSH |
| | A1.3. Mbështeja e familjeve të varfëra nëpërmjet ofrimit të NE nga fondi 6% | Mbi 220 familje ne vit përfitojnë nga skema e NE me fondin 6% | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | SHSSH |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A1.4 Mbështeja e familjeve të varfëra nëpërmjet ofrimit të NE nga buxhetimi bashkise | Mbi 100 familje ne vit përfitojnë NE nga fondet e Bashkisë | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | |
| | | Rreth 3.500.000 leke ne vit alokohen nga Bashkia Elbasan për NE | 2025 | 2028 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Drejtoria e buxhetit iii)Bashkia Elbasan | |
| | A1.5. Evidentimi, gjurmimi, dhe largimi nga skema e NE e familjeve abuzive | 5% e familjeve të verifikuara largohen nga skema | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | |
| | A1.6 Ulje e numrit të familjeve që janë përfituese nga skema e Ndihmës Ekonomike përmes integrimit në skemat e punësimit | i) Mbi 70% e familjeve përfituese të NE mbi 5 vite, nxiten te largohen nga skema e NE npërmjet punësimit ii) 10% e familjeve përfituese të NE punësohen dhe largohen nga skema e NE | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | Zyra e Punësimit Elbasan |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***A 2 Fuqizimi ekonomik i grupeve te disavatazh uara*** | A 2.1 Hartimit të politikave lokale mbështetëse dhe planifikimit të fondeve për inisiativat private te vetpunësimit të tyre | i) Buxheti i Bashkisë parashikon fonde per mbështetjen e inisiativeve te punësimit për të rinjtë,<br>ii) Buxheti i Bashkisë parashikon fonde per mbështetjen e inisiativeve te punësimit për të grate dhe vajzat | 2025 | 2028 | i)Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale<br>ii) Drejtoria e Buxhetit Bashkia Elbasan | |
| | A 2.2 Nxitjes se inisiativave lokale nëpërmjet mbështetjes së Ndërmarrjeve sociale . | Te pakten një sipërmarrje sociale e ngritur dhe funksionale në Bashkinë Elbasan | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | Ministria e Shendetesise dhe mbrotjes sociale |
| ***A 3 Mbështetje të individeve dhefamilje ve vulnerabel nga skemat te tjera*** | A 3.1 Pëmirësimi i kushteve të jetësës per individet dhe grupet ne nevojë nëpërmjet shërbimit të Strehimit | i) Nr familjeve përfituese të bonusit të qërase<br>ii) Nr familjeve përfituese me shtepi sociale | 2025 | 2028 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Drejtoria e strehimit | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***mbështetës e të ofruara nga bashkia*** | A 3.2 Mbështjetje familjeve për lindjet e reja për bonusin për bebet | 100% e familjeve të cilët lindin fëmijë përfitojnë bonusin e bebit | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | Ministria e Shendtesise dhe Mbrojtjes Sociale |
| | A 3.3 Mbështetja familjeve, fëmijët e të cilëve ndjekun ciklin e detyruar arsimor | 100% e fëmijëve ndjekin arsimin bazë | 2025 | 2028 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Drejtoria Arsimore Bashkia Elbasan | |
| | A3.4 Mbështetje familjeve në nevojë për mbulimin e nevojave për ngrohje gjatë dimrit | mbi 30% e familjeve në nevojë në vit përfitojnë nga ulja e tarifës për drutë e zgjarrit për ngrohja | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | |
| | A 3.5 Hartimi i protokolleve të mbështetjes së individëve dhe familjevë në nevojë në rast epidemie/pandemie/emergjence | 3 protokolle hartohen, miratohen dhe behen pjesë integrale e programit të emergjencave ne Bashkinë Elbasan | 2025 | 2028 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Drejtoria e Emergjencave Civile | OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ndërgjegjësimi i publikut, grupeve të interesit dhe aktorëve në zbatimin e NE | 54 fushata ndërgjegjësue se (18 NJA x 1 fushatë në vit x 3 vite) | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| **Objektivi Strategjik: Zhvillimi i Aftësisë së Kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në para me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike të personave me aftësi të kufizuar.**<br><br>**Objektivi Specifik B. Përfitimi për aftësinë e kufizuar e integruar me shërbime shoqërore për personat me aftësi të kufizuar.** | | | | | | |
| ***B1 Rritja e efikasitetit të mbështetjes së personave me aftësi të kufizuar*** | B1.1 Evidentimi i personave me aftësi të kufizuar dhe vlerësimi i nevojave të tyre | Databaze me të dhënat e personave me aftësi të kufizuar dhe evidentimi i nevojave për ndihmë është ngritur | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | B1.2 Bashkëpunimi me SHSSH /Komisionet Shumëdisiplinore të vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KSHVAK) në Bashkinë Elbasan për mbështetjen dhe asistimin e personave | Rreth 100% persona që aplikojë për përfitim të AK asistohen dhe mbështeten për vlerësimin bio-psiko-social nga KSHVAK | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | DRSHSSH Elbasan |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | aplikues të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar | | | | | |
| | B1.3. Standartizimi dhe unifikimi i planit zhvillimor një vjeçar për personat me AK të vlerësuar nga KSHVAF | 1 (një) guidë dhe një format i planit zhvillimor 1 vjeçar i unifikuar i realizuar | 2025 | 2026 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | DRSHSSH Elbasan<br><br>OJF |
| | B1.4. Aftësimi i Adminsitratorëve Shoqërorë për hartimin e planit zhvillimor 1 vjecar dhe monitorimin e tij | i) 1 (një) trajnim i realizuar<br>ii) 14 administratorë shoqërorë aftësohen të hartojnë dhe monitorojnë planet zhvillimore 1 vjecare | 2025 | 2026 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | DRSHSSH Elbasan<br><br>OJF |
| | B1.5 Evidentimi, gjurmimi dhe largimi nga përfitimi i AK i rastevr abuzive | 5% e rasteve abuzive evitentohen dhe largohen nga përfitimi i AK | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | DRSHSSH Elbasan |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | B1.6 Standartizimi, unifikimi dhe plotësimi me të dhëna të tjera të rregjistrit të AK që përdorin administratorët shoqërorë | Një rregjistër i unifikuar i AK i realizuar | 2025 | 2026 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | DRSHSSH Elbasan |
| | B1.7 Institucionalizimi i bashkëpunimit të Bashkisë Elbasan me ofruesit e aktorët lokalë që kanë në fokus Aftësinë e Kufizuar | Marrëveshje të nënshkruara me : ZA Elbasan, DSHP Elbasan, Zyrën e Punësimit Elbasan, inspektorianti n e Punës, Dhomën e Tregtisë Elbasan, OJF | 2025 | 2026 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Drejtoria Juridike Bashkia Elbasan | ZA Elbasan, DSHP Elbasan, Zyrën e Punësimit Elbasan, Inspektoriant i i Punës, Dhomën e Tregtisë Elbasan, OJF të ndryshmë |
| | B1.8Aftësimi i Ndihmësave Personalë për të ofruar shërbime cilësorë për PAK | i) 1 (një) modul i hartuar ii) 18 administrator ë shoqërorë aftësohen të trajnojnë Ndihmësat Personalë iii) Çdo ndihmës personal i trajnuar për | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | DRSHSSH Elbasan<br><br>OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shërbimin që do të ofrojnë | | | | |
| ***B2 Fuqizimi ekonomik i PAK*** | B 2.1 Fuqizimi ekonomik i PAK nëpërmjet Fondit Social | i) Projekte te ideuara dhe te hartuara<br>ii) 2 aplikime Fondi Social | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | MSHMS dhe OJF |
| | B2 .2 Hartimit të politikave lokale mbështetëse dhe planifikimit të fondeve për inisiativat private te vetpunësimit të tyre | i) Ndërtimi i një databaze të bisneseve të drejtuar nga PAK<br>ii) Studim mbi nevojat për mbështetje të tyre<br>iii)Paketa fiskale 2025 përfshin lehtësira për bizneset e drejtuara nga PAK | 2025 | 2026 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Drejtoria e Taksave Bashkia Elbasan | Zyra e Punës dhe OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | B2.3 Këshillimi për aftësimin e PAK për punësim | 30% e PAK me kufizime të lehta këshillohen rreth aftësive për jetën dhe punësim | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | Zyra e Punës dhe OJF |
| ***B3 Ofrim për personat më AK dhe familjeve të tyre të shërbimeve nga skëma të tjera mbështetës e nga Bashkia Elbasan*** | B 3.1 Mbështetje të familjeve të personave me AK nga skemat e strehimit | i) Nr PAK përfituese të bonusit të qerasë<br>ii) Nr PAK përfituese të shtepisë sociale<br>iii) Nr i PAK përfituese të qerasë së butë | 2025 | 2028 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Drejtoria e Strehimit | |
| | B 3.2 Mbështetje në kohë reale të personave me AK në kushtet e epidemie/pandemie/emergjence nëpërmjet hartimit të zbatimit të protokolleve të mbështetjes së personave me AK në rast | 3 protokolle hartohen, miratohen dhe bëhen pjesë integrale e programit të emergjencave në Bashkinë Elbasan | 2025 | 2026 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale<br>ii) Drejtoria e Emergjencave Civile Bashkia | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***B4 Ndërgjegjësimi i publikut, grupeve të interesit dhe aktorëve të për përfitimin e AK përmes fushatave të komunikimit dhe informimit.*** | B4.1 Realizimi i fushatave ndërgjegjësuese | 54 fushata ndërgjegjësuese ( 18 NJA x 1 fushatë në vit x 4 vite) | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | Institucione lokale dhe OJF |
| **Objektivi Strategjik: Shërbime të integruara të kujdesit shoqërore me standarde për të gjitha kategoritë në nevojë në të gjithë territorin e bashkisë.**<br><br>**Objektivi Specifik C. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale** | | | | | | |
| ***C1. Ngritja e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel lokal deri në 2026.*** | 1.1 Evidentimi i personave që kërkojnë mbështetje dhe vlerësimi i nevojave të tyre | Databaza me të dhënat e individëve në nevojë ( për çdo kategori) është ngritur | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | 1.2Rishikimi vjetor i planit social vendor | Plani social vendor rishikohet cdo vit | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1.3Paraqitja e një harte të qartë mbi shtrirjen që kanë qendrat që ofrojnë shërbime të kujdesit social dhe gjendjen në të cilën ndodhen këto qendra | i) Hartohet harta e shtrirjes së shërbimeve sociale dhe publikohet në ëeb e bashkisë<br>ii) Rishikimi i vjetor i hartës | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | 1.4 Kostimi i shërbimeve rezidenciale dhe ditore për të rritur dhe të mitur në Bashkinë Elbasan | Katë kostime shërbimesh rezidenciale dhe ditore të realizuara ( për të mitur dhe për të rritur) | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | 1.5 Shërbime parashoqërore të ofruara për përfituesit nga ofruesit e shërbimeve | 100% e përfitueseve të shërbimeve shoqërore përfitojnë shërbim para se të frekuentojnë shërbimet | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | institucione lokale dhe OJF |
| | 1.6 Ngritja e qendrës së emergjence dhe pajisja me të gjitha standartet për shërbimet rezidenciale dhe ditore për fëmijët në nevojë për mbrotje | Një qendër emergjence e ngritur dhe funksionale | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | institucione lokale dhe OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1.7 Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve lëvizëse nëpërmjet Fondit Social | i)Të paktën 2 aplikime per Fond Social ii) Dy shërbime lëvizëse të ngritura dhe funksionale | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | MSHMS OJF |
| | 1.8 Shërbime shoqërore për fëmijët | | 2025 | 2028 | | |
| | *1.8.1 Ngritja e qendrave multifunksionale për fëmijët dhe komunitetin* | Ngritja e të paktën 2 (dy) qendrave multifunksionale për fëmijët dhe komunitetin | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | *1.8.2 Shërbime këshilluese dhe riintegruese për të miturit në konflikt me ligjin* | 10 të mitur në vit përfitojnë shërbime riintegruese | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | Shërbimi i Provës Elbasan OJF |
| | 1.8.3 Shërbime të specializuar për fëmijët në nevojë për mbrotje | 1 (një ) shërbim lëvizës i ngritur dhe funksional | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | 1.8.4 Ulja e kohës së qëndrimit të fëmijëve në qendrat rezidenciale | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | a) Rekrutimi i familjeve kujdestare për të ofruar shërbimin e kujdestarisë së përkohshme për fëmijët që kanë nevojë për kujdes alternative, hartimi i rregjistrit të familjeve kujdestari dhe trajnimi i tyre për ofrimin e shërbimeve të kujdestarisë | i) 30 familje të trajnuara<br>ii) 5 nga familjet e trajnuara plotësojnë dokumentacionin dhe pranojnë të bëhen familje kujdestare<br>iii) 5 familje rregjistrohen në rregjistrin e familjeve kujdestare në Bashkinë Elbasan | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | b) Fuqizimi social ekonomik i familjeve biologjike | i) rreth 10 prindër biologjikë përfitojnë formim profesional<br>ii) 5 prindër biologjikë të punësuar | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | Dhoma e tregtise, Zyra e Punësimit dhe OJF |
| | c)Fëmijët që trajtohen në qendrat rezidenciale rikthehen në familjen biologjike | % e fëmijëve të rikthyer në familjen biologjike | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | d) Fushatë ngërgjegjësuese për rëndësinë dhe rolin e familjes kujdestarë | i) Kalendari fushatave ndërgjegjësue se i hartuar dhe miratuar ii) Evidentimi i familjeve potenciale për tu bërë familje kujdestare iii)18 fushata ndërgjegjësue se të realizuara iv)360 familje, pjesmarrëse në fushata v) 5 familje pranojnë dhe nisin praktikën për tu bërë familje kujdestare | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | 1.8.5 Rritja e bashkëpunimit dhe e advokacisë për buxhetim me focus mbrojtjen e fëmijëve | | | | | |
| | *a) Kostimi i menaxhimit te rastit per fëmijet* | Miratimi në këshill bashkiak i kostove të shërbimit për fëmijë ( sipas | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | natyrës dhe nevojës) | | | | |
| | b) fondi nga taksat lokale i alokuar për mbrotjen e fëmijëve | i)Parashikim i raste të fëmijëve që kërkojnë mbrojtje<br>ii) % e buxhetit të bashkisë alokohet për menaxhimin e fëmijëve në nevojë | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | 1.8.6 Ndërgjegjësimi institucional dhe komunitar mbi të drejtat e fëmijëve | i) 18 aktiviteteve të realizuara<br>ii) 10 institucioneve të trajnuara<br>iii) 360 pjesmarrës në trajnim | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | 1.8.7 Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese me tematikë respektimin e të drejtave të fëmijëve | i) 54 aktiviteteve të realizuara<br>ii) 10.000 materialeve informuese të realizuara dhe të shpërndara<br>iii) 3 | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | emisioneve tv të realizuara | | | | |
| | 1.8.8 Hartimi i protokolleve të mbështetjes së të miturit në rast epidemie/pandemie/emergjence | 3 protokolle hartohen, miratohen dhe behen pjesë integrale e programit të emergjencave ne Bashkinë Elbasan | 2025 | 2026 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | 1.9 Shërbime shoqërore për personat me Aftësi të Kufizuar | | | | | |
| | *1.9.1 Shërbimeve të specializuara për fëmijët PAK* | 2 (dy) shërbime të specializuara për fëmijë me AK të ngritura | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | *1.9.2 Shërbime të specializuara për të rritur* | 2 (dy) Shërbime të specializuara për të rritur me AK të ngritura | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | *1.9.3 Aktivitete shoqërore për persona me aftësi të kufizuar* | i) 10 aktiviteteve/ vit të realizuara ii) 200 Persona me AK pjesmarrës në aktivitete në vit | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | 1.9.4 Rritja e bashkëpunimit dhe e advikacisë për buxhetim me focus AK | | | | | |
| | *i) Kostimi i shërbimit* | Miratimi në këshill bashkiak i kostove të shërbimit PAK ( sipas natyrës dhe nevojës) | 2025 | 2026 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | *ii) fondi nga taksat lokale i alokuar për AK* | i) Evidentimi i PAK që kërkojnë mbështetje ii) % e buxhetit të bashkisë alokohet për menaxhimin e PAK në nevojë | 2026 | 2027 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | 1.10 Shërbime shoqërore për moshën e tretë | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | *1.10.1 Evidentimi i problematikës së moshës së tretë dhe hartimi i një databaze të të moshuarve në nevojë* | 1 (një) Data baze e ndërtuar dhe funksionale | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | *1.10.2 Shërbimeve të specializuara për moshën e tretë* | 2 (dy) shërbime të specializuara për moshën e tretë | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | *1.10.3 Shërbime në familje për moshën e tretë* | 1 (një) shërbim në familje i ofruar për moshën e tretë | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | *1.10.4 Aktivitete shoqërore për moshën e tretë* | i) 10 aktiviteteve/ vit të realizuara<br>ii) 200 pjesmarrës në aktivitete në vit | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| | 1.10.5 Rritja e bashkëpunimit dhe e advikacisë për buxhetim me focus te moshuar | | | | | |
| | *i) Kostimi i shërbimeve për moshën e tretë* | Miratimi në këshill bashkiak i kostove të shërbimit për të moshuar ( | 2025 | 2026 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sipas natyrës dhe nevojës) | | | | |
| | *ii) Financimi i shërbimeve për moshën e tretë nga nga taksat lokale* | % e buxhetit të bashkisë alokohet për menaxhimin e nevojave për të moshuar në nevojë | 2026 | 2027 | i)Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale<br>ii) Drejtoria e buxhetit bashkia Elbasan | |
| | 1.10.6 Hartimi i protokolleve të mbështetjes së personave të moshuar të vetmuar në rast epidemie/pandemie/emergjence | 3 protokolle hartohe, miratohen dhe bëhen pjesë integrale e programit të emergjencave në Bashkinë Elbasan | 2025 | 2026 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |
| ***C2. Konsolidimi i sistemit të integruar të shërbimeve ekzistuese*** | 2.1 Mirëfunksionimi i shërbimeve publike që ofrohen në qendrat publike për target grupe fëmijë | i) Nr fëmijëve që marrin shërbim<br>ii) Nr shërbimeve ofrohen për fëmijet<br>iii) Nr Shërbimeve që financohen nga Bashkia ( totalisht ose pjeserisht)<br>iv) Fondi i | 2025 | 2028 | i)Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale<br>ii) Drejtoria e buxhetit Bashkia Elbasan | OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Bashkisë i ofruar | | | | |
| | 2.2 Mirëfunksionimi i shërbimeve që ofrohen në qendrat publike për target grupe të rinj me aftësi të kufizuar | i) Nr i PAK që marrin shërbim<br>ii) Nr i shërbimeve ofrohen për PAK<br>ii) Shërbime të financuara nga Bashkia ( totalisht ose pjeserisht) | 2025 | 2028 | i)Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale<br>ii) Drejtoria e Buxhetit Bashkia Elbasan | OJF |
| | 2.3 Mirëfunksionimi i shërbimeve që ofrohen në qendrat publike për t arget grupe mosha e tretë | i) Nr të moshuar që marrin shërbim<br>ii) Nr i shërbimeve ofrohen për të moshuar<br>iii) Nr Shërbimesh financohen nga Bashkia ( totalisht ose pjeserisht)<br>iv) Fondi i Bashkisë i ofruar | 2025 | 2028 | i)Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale<br>ii) Drejtoria e Buxhetit Bashkia Elbasan | OJF |
| | 2.4 Fuqizimi i rrjetit të vullneraréve në mbështetje të grupeve në nevojë | i) 5 Rrjete të krijuara<br>ii) 50 të rinj vullnetarë mbështesin | 2025 | 2028 | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale | OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | : PAK dhe të moshuar | grupet në nevojë | | | | |
| **Objektivi Strategjik: Fuqizimi, riorganizimi dhe koordinimi i shërbimeve sociale në Bashki**<br><br>**Objektivi Specifik D Kapacitetet njerzore dhe financiare te bashkise qe i pergjigjen nevojave per sherbime sociale te integruara per te gjitha kategorite ne nevoje;** | | | | | | |
| ***D1 Riorganizimit të Sektorit të Mbrojtjes dhe Kujdesjes Sociale (Ndihma Ekonomike dhe Aftësia e Kufizuar).*** | 1.1 Vlerësimi i ngarkesës së punës për NE dhe PAK të administratorëve shoqërorë në Bashkinë Elbasan ( për qytetin dhe njësitë administrative ) | i) 1 (një) Matricë e vleresimit te punes se hartuar ii) Grumbullimi periodik i matricave iii) Një Raport i hartuar mbi matricat | 2025 | 2026 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Departamenti i Burimeve Njerezore | |
| | 1.2 Rishikimi i përshkrimit të punës së administratorëve shoqërorë ( për qytetin dhe njësitë administrative ) | Çdo adminsitrator shoqëror ka një përshkrim pune të detajuar | 2025 | 2026 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Departamenti i Burimeve Njerezore | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1.3 Riorganizimi i strukturës për zbatimin e NE dhe AK në nivel bashkie | i)Sektori i NE i ngritur dhe funksional<br>ii) Sektori i AK i ngritur dhe funksional<br>iii) 1 (një) adminsitrator shoqëror i shtuar për AK në 2023<br>iv) 2 (dy) adminsitratorë shoqërore për AK të shtuar deri në 2026 | 2025 | 2028 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Departamenti i Burimeve Njerezore | |
| | 1.4 Rritja e kapaciteteve të strukturave të Bashkisë, në fusha që përfshijnë administrimin dhe monitorimin e skemës së Ndihmës Ekonomike dhe Aftësinë e Kufizuar | i) 3 (tre) trajnime të realizuara<br>ii) 30 adminsitratoreve që përmirësojnë përformancen ne punë | 2025 | 2028 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Departamenti i Burimeve Njerezore | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***D2 Riorganizimit të Sektorit Kujdesit të Shtresave në Nevojë dhe Moshës së Tretë*** | 2.1 Plotësimi i stafit ne sektorin e shtresave ne nevoja dhe mosha e trere | i) Sektori i riorganizuar i ngritur dhe funksional ii) 1 (një) Specialist i shtuar për grupet në nevoje dhe moshën e tretë në vitin 2024 iii) 1 (një) specialist i shtuar per etnitë në vitin 2025 | 2025 | 2028 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Departamenti i Burimeve Njerezore iii) NJVNR në Njësitë Adminsitrativ e | |
| ***D 3 Riorganizimi dhe fuqizimi Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në çdo njësi administrative*** | 3.1 Riorganizimi dhe Forcimi i NJVMR per rolin e PMF dhe punonjesit social | i) 6 trajnime të realizuara ii) Të gjitha NJVMR në njësitë Adminsitrativ e rritin kapacitetet për rolin e PMF dhe punonjësit social | 2025 | 2028 | i) Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar ii) Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashki dhe iii) NJMRV | OJF |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***4. Fuqizimi i struktuës së monitorimit të cilësisë së shërbimeve sociale në nivel lokal.*** | 4.1 Rritja e kapaciteteve të strukturës së monitorim vlerësimit | i) 6 trajnime të realizuara ii) I gjithë stafi i sektorit të monitorimit rrit kapacitetet monitoruese dhe vlerësuese | 2025 | 2028 | i) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ii) Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashki dhe iii) Sektori i monitorim vlerësimit | OJF |

## BURIMET FINANCIARE

**Ky kapitull trajton në mënyrë të përmbledhur burimet financiare, të nevojshme për zbatimin e "Planit Social 2024-2027" për Bashkinë Elbasan.**

Kostimi i planit të veprimit u realizua mbështetur në masat, aktivitetet dhe indikatorët e përcaktuar në matricën e veprimeve. Për kostimin e planit të veprimit u përdor një metodologji e kombinuar, pasi plani përfshin disa sektorë dhe për një pjesë të aktiviteteve ka dhe bashkëfinancim me institucione të tjera dhe ose organizata partnere. Metodologjia kryesore e përdorur është kostimi i bazuar në aktivitete. Kostimi u realizua duke u mbështetur në koston e secilit aktivitet të pasqyruar në planin e veprimit. Në llogaritjen e shpenzimeve totale u mbajt në konsideratë kohështrirja e masës, numri i aktiviteteve që do të realizohen, numri i përfituesve për aktivitete të caktuara, etj. Në disa raste u përdor dhe vlerësimi për analogji, sidomos në projektet për krijimin e shërbimeve të reja, i cili merr në konsideratë shpenzimet e bëra për qendra të ngjashme. Për aktivitetet që planifikohen të mbulohen nga buxheti i qeverisë qëndore përmes transfertës së kushtëzuar u mbajtën në konsideratë kostot për njësi sipas PBA 2023-2026. Kostimi i Planit të Veprimit u realizua gjithashtu bazuar në praktikën e planifikimit buxhetor dhe metodologjinë e hartimit të buxhetit afatmesëm.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e masave, nga të gjitha burimet e financimit, është rreth 4.16 miliardë lekë ose afërsisht 37.8 milionë euro[10]. Alokimi i fondeve për periudhën 2024-2027 u programua duke mbajtur në konsideratë tavanet e projektbuxhetit afatmesëm (PBA 2023-2025). Burimet financiare nga buxheti i shtetit mbulojnë rreth 11.8% të shpenzimeve së planit të veprimit, përkatësisht rreth 492.7 milionë lekë. Ndërsa burimet e financimit të angazhuara nga bashkia mbulojnë 83.1% të shpenzimeve së planit të veprimit ose 106.3 milionë lekë.

[10] Kursi këmbimit 1Euro=110 lekë

Tabela 1 paraqet buxhetin në vite sipas objektivave specifike. 85.9% e shpenzimeve nevojiten për Objektivin Specifik A. " Ulja e varfërisë nëpërmjet rritjes së efektivitetit të skemës së NE", ndërsa 13.1% për Objektivin Specifik C "Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale ".

**Tabela 1: Buxheti sipas objektivave strategjik për periudhën 2024-2027**

| Përshkrimi | Buxheti 2024-2027 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| OBJEKTIVAT | Viti 2024 | Viti 2025 | Viti 2026 | Viti 2027 | TOTALI |
| Objektivi Specifik : A. Ulja e varfërisë nëpërmjet rritjes së efektivitetit të skemës së NE | 891,854,480.00 | 896,723,051.00 | 894,589,622.60 | 893,903,908.40 | 3,577,071,062.00 |
| Objektivi Specifik B. Përfitimi për aftësinë e kufizuar e integruar me shërbime shoqërore për personat me aftësi të kufizuar | 6,176,640.00 | 7,828,020.00 | 6,553,670.00 | 6,496,520.00 | 27,054,850.00 |
| Objektivi Specifik C. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale | 70,405,640.00 | 161,512,390.00 | 156,920,790.00 | 156,992,390.00 | 545,831,210.00 |
| Objektivi Specifik D: Kapacitetet njerzore dhe financiare te bashkise qe i pergjigjen nevojave per sherbime sociale te integruara per te gjitha | 1,405,656.00 | 2,944,512.00 | 3,816,768.00 | 5,561,280.00 | 13,728,216.00 |
| TOTAL (A+B+C+D) | 969,842,416.00 | 1,069,007,973.00 | 1,061,880,860.60 | 1,062,954,098.40 | 4,163,686,338.00 |

Tabela 2 paraqet shpenzimet sipas burimeve të financimit dhe hendekun financiar për secilin nga objektivat specifikë. Shpenzimet për ngritjen e shërbimeve të reja janë planifikuar me bashkëfinancim me qeverinë përmes fondit social. Hendeku financiar i pambuluar nga të gjitha burimet e financimit është 5.0%%. Një pjesë e hendekut financiar kërkon alokimin e fondeve nga bashkia dhe buxheti i shtetit, ndërsa pjesa tjetër mendohet të mbulohet nga donatorë të ndryshëm dhe organizata të shoqërisë civile.

**Tabela 2: Shpenzimet sipas burimeve të financimit**

| Përshkrimi | | FINANCUAR NGA | | | | Nevojat për | Llogaria e Shpenzimeve | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| OBJEKTIVAT | Bashkia | Qeveria | Donatorët | Të tjerë | Totali | Fonde LEKË | 600-601 | 602-608 | 230-231 |
| Objektivi Specifik : A. Ulja e varfërisë nëpërmjet rritjes së efektivitetit të skemës së NE | 3,088,533,440.00 | 484,217,622.00 | 0.00 | 0.00 | 3,572,751,062.00 | 4,320,000.00 | 12,313,920.00 | 3,564,757,142.00 | 0.00 |
| Objektivi Specifik B. Përfitimi për aftësinë e kufizuar e integruar me shërbime shoqërore për personat me aftësi të kufizuar | 15,418,310.00 | 419,100.00 | 0.00 | 1,500,000.00 | 17,337,410.00 | 9,717,440.00 | 8,538,210.00 | 15,596,640.00 | 2,920,000.00 |
| Objektivi Specifik C. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale | 342,316,010.00 | 8,058,000.00 | 0.00 | 457,200.00 | 350,831,210.00 | 195,000,000.00 | 329,263,810.00 | 184,567,400.00 | 32,000,000.00 |
| Objektivi Specifik D: Kapacitetet njerzore dhe financiare te bashkise qe i pergjigjen nevojave per sherbime sociale te integruara per te gjitha | 12,528,216.00 | 0.00 | 0.00 | 1,200,000.00 | 13,728,216.00 | 0.00 | 10,152,216.00 | 3,576,000.00 | 0.00 |
| TOTAL (A+B+C+D) | 3,458,795,976.00 | 492,694,722.00 | 0.00 | 3,157,200.00 | 3,954,647,898.00 | 209,037,440.00 | 360,268,156.00 | 3,768,497,182.00 | 34,920,000.00 |

## V. SHTOJCË PËR PAKICAT ROME E EGJIPTIANE

Në qytetin e Elbasanit jetojnë afërsisht 1800 banorë që i përkasin pakicave Rome dhe 6500 banorë që i përkasin pakicave Egjiptiane (të dhëna sipas Censusit të fundit). Shumica e pakicave rome banojnë në lagjen '5 Maj' (Rrapishte), në bashkëjetesë me pjesën tjetër të komunitetit.

Komuniteti rom bashkëjeton në harmoni të plotë me pjesën tjetër të shoqërisë nga ku dallohet qëndrimi i tyre prej shumë vitesh në të njëjtën zonë banimi lagjen" 5 Maj". Bashkia Elbasan për tu ardhur në ndihmë ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për këtë komunitet ka ngritur struktura të efektshme të cilat bashkëpunojnë me të gjithë aktorët lokal për identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e shërbimeve të ofruara.

**Përshkrim i përgjithshëm i Planit vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane (2019-2022) të Bashkisë Elbasan.**

Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane për Bashkinë Elbasan ishte një zhvillim progresiv i Planit Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, si dhe Planit për Mbrojtjen Sociale 2017-2022 të miratuar nga Bashkia Elbasan, i cili synoi zbatimin e masave për lehtësimin e integrimit të komunitetit, si dhe zhvillimin progresiv të tij, në vijim të angazhimit politik të Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak dhe në frymën e bashkëpunimit me projektin ROMACTED[11]. Gjithashtu, mbrojtja e të drejtave të njeriut përfshirë agjendën rome dhe politikat jodiskriminuese është një nga pesë prioritetet e agjendës së integrimit evropian të Shqipërisë, që përfshin "masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët dhe politikat antidiskriminuese".

Masat e Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane për Bashkinë Elbasan u grupuan në 6 fusha prioritare: regjistrimi civil, arsimi, punësimi dhe zhvillimi i aftësive, shëndetësia, strehimi dhe integrimi urban, dhe mbrojtja sociale.

***Vizioni:*** *Rritja e aksesit në shërbimet publike nëpërmjet heqjes së vazhdueshme të barrierave për romët dhe egjiptianët përgjatë katër viteve do të sjellë një shëndet më të mirë, një arsimim më të plotë, rritje të mirëqenies nëpërmjet punësimit formal e si pasojë integrim të plotë të pakicave rome dhe egjiptiane.*

***Qëllimet Strategjike:***

[11] *Në këtë kuadër është nënshkruar edhe një memorandum mirëkuptimi midis palëve.*

- Lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të regjistrimit civil dhe drejtësisë për romët dhe egjiptianët.
- Romët dhe egjiptianët të gëzojnë akses dhe përfshirje të plotë në arsim cilësor duke mos qenë subjekt i diskriminimit dhe segregimit.
- Krijimi i mundësive të barabarta për punësimin formal të romëve dhe egjiptianëve.
- Garantimi i një kujdesi mjekësor të aksesueshëm, të përballueshëm dhe të barabartë për romët dhe egjiptianët.
- Përmirësimi i kushteve të strehimit për romët dhe egjiptianët.
- Rritja e aksesit në programet e mbrojtjes sociale për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane.

**Sfidat të hasura gjate zbatimit të Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane për Bashkinë Elbasan**

Një nga problematikat kryesore që ka ndikuar në zbatimin e planit lokal ishte Pandemia e Covid-19. Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit u alokua për dezifektimin e qytetit dhe të shkollave. Në kohën e karantinës shumë familje nuk kishin financa të mjaftueshme për të siguruar ushqimin në familjet e tyre. Ky ka qënë shkaku kryesor që shumë aktivitete nuk janë realizuar sepse u ndërmorën masat anti-covid.

Arsyeja pse nuk është hartuar një plan i ri është sepse pas raportit te monitorimit mbi zbatimin e **Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane** 2019-2022 përvec problematikave që solli situata e paparishikuar e pandemisë COVID-19 ishte gjithashtu edhe një sërë objektivash ambicioze që ne kishim parashikuar por që në realitet hasëm një sërë vështirësisë në zbatim. Si rrjedhojë pas shumë diskutimesh edhe takimesh me aktorë të tjerë arritëm në përfundimin që nuk na nevojitet një plan i vecantë pasi Plani i Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2024-2027 përshkruan prioritetet e Bashkisë Elbasan në fushën e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale për të gjithë target grupet dhe zgjidhja më efikase do të jetë kjo shtojcë që do ti bashkangjitet Planit të Mbrojtjes Sociale 2024-2027.

Megjithatë angazhimi i Bashkisë Elbasan në lidhje me pakicat rome e egjiptiane ka qënë maksimal prej vitesh por gjithashtu edhe në kuadër të realizimit të qëllimeve dhe objektiva të përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025.

**Deri më tani janë realizuar këto aktivitete sipas politikave dhe fushave prioritare që përmban Plani Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025:**

## PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MBROJTJEN SOCIALE 2025-2028

**1.Regjistrimi Civil**, Bashkia ndjek proçedurat duke bashkëpunuar me organizatat rome e egjiptiane lokale dhe kombëtare për regjistrimin në gjendjën civile të të miturve. Suporti ligjor falas kemi pasur edhe nga organizata TLAS e cila ndjek të gjitha proçedurat gjyqësore për shkak të mungesës së dokumentacioneve përkatëse.

**2. Arsimi dhe dialogu ndërkulturor**, Bashkia Elbasan ka ndjekur hap pas hapi proçesin e identifikimit dhe referimit të rasteve të fëmijëve të këtij minoriteti në çerdhe, kopshte dhe shkolla. Në koordinim me aktorët lokal dhe ZVA Elbasan hartohet lista e fëmijëve që nisin klasën e parë, lista e fëmijëve të cilët për arsye të ndryshme që kanë braktisur shkollën ose fëmijë që janë transferuar nga Shqipëria drejt shteteve të tjera. Rastet e fëmijëve që kanë braktisur shkollën janë në monitorim të vazhdueshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social, Arsimit e Rinisë.

**3. Punësimi dhe arsimi profesional**, Identifikim i rasteve nga Bashkia ndërgjegjësim dhe referimi i tyre pranë Zyrave të Punës për të kuptuar përfitimet që rrjedhin nga regjistrimi si punëkërkues i papunë në programet e nxitjes së punësimit apo për orientim drejt kurseve të formimit profesional.

**4.Kujdesi shëndetësor**, Bashkia Elbasan në bashkupinim të vazhdueshëm me NJVKSH realizon aktivitete informuese në lidhje për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e vaksinimit te femijeve, kujdesit ndaj higjenës, planifikimit familjar, kancerit të gjirit etj.

**5.Strehimi dhe integrimi urban**, informim dhe referim mbi aplikimin për përfitim të bonusit të qerasë apo programe te ndryshme qe ka Zyra e Strehimit.

**6. Mbrojtja Sociale**, Vlerësimi i nevojave për shërbime sociale dhe i kapaciteteve të institucioneve vendore për të adresuar parime thelbësore duke ju referuar nevojave dhe specifikave lokale të Bashkisë Elbasan.

Menaxhimi i rasteve sipas specifikave ( familje në nevojë, dhunë në familje dhe persona me aftësi të kufizuar) nëpërmjet tryezave ndërsektoriale duke i trajtuar me plane individuale.

Vazhdimi i funksionimit të gjashtë skuadrave të terrenit të cilët kanë në përbërjen e tyre punonjës të Drejtorisë të Kujdesit Social, Arsimit e Rinisë, Agjensisë së Shërbimeve Sociale si dhe përfaqësues të aktorëve lokal që kanë në fokus fëmijët. Këto skuadra identifikojnë dhe monitorojnë rastet e fëmijëve që shfrytëzohen për punë të ndryshme (lypje, shitje ambulatore, mbledhjen e mbeturinave te riciklueshme etj.)

Për fëmijët që vijnë nga familje me probleme social-ekonomike është bërë koordinim e referim midis strukturave për të përfituar shërbime nga qendra multifunksionale publike dhe jopublike që operojnë në qytetin e Elbasanit. Shërbime që konsistojnë në kryerjen e mësimeve pas shkolle, informim mbi situatën aktuale, aktivitete psiko-sociale.

## PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MBROJTJEN SOCIALE 2025-2028

Bashkia Elbasan ka ngritur prej vitesh Qendrën Komunitare Rome QKR e cila është në varësi të Agjensisë së Shërbimeve Sociale ASHC e cila ofron edukim, arsimim, dhe aktivitete argëtuese për komunitetin rom dhe jo vetëm, gjithashtu aktivitete te njëjta ofrojnë dhe qendrat e tjera si Qendra Komunitare ne Njësinë Administrative Shushicë, Qendra Multifunksionale mbështetur nga Terre des Homme, Qendra Komunitare e Aid to Balkans Albania. Këto qendra per nga vendndodhja që kanë mbulojnë shërbime për një numër të konsiderueshëm të fëmijëve dhe familjeve të tyre që vijnë nga pakicat rome e egjiptiane.

| **Fusha e ndërhyrjes: Aksesi Barabartë në Regjistrimin Civil dhe në Drejtësi** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi specifik: 1.** Lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të regjistrimit civil dhe drejtësisë për romët dhe egjiptianët<br><br>**<u>Treguesi i Objektivit:</u>** 90% e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian do të kenë akses të plotë në shërbimin e gjendjes civile në fund të vitit 2028. | | | | | | |
| **Masa/Aktiviteti** | **Aktorët** | **Treguesit e rezultateve** | **Burimet e të dhënave** | **Afatet** | **Kostimi ne vit** | **Monitorimi** |
| 1.1 Dhënia e ndihmës për marrjen e dokumenteve për fëmijët e lindur jashtë vendit | Qendra Komunitare Rome (QKR), Agjensia e Sherbimit Social Bashkia Elbasan (ASHS) dhe Zyra e Gjendjes Civile (ZGJC). | Baza e referimit – viti 2025. Indikator të matshem | Raport i paraqitur nga QKR, ASHS dhe ZGJC ne Bashki | Çdo vit | **34, 300 lekë** Buxheti vendor | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (MPS) në Bashki |
| 1.2 Raportimi pranë zyrave të gjendjes civile i fëmijëve të paregjistruar, përfshirë ata | Qendra Komunitare Rome (QKR), Agjensia e Sherbimit Social Bashkia Elbasan | Indikator të matshem Çdo vit. | Raport i paraqitur nga QKR dhe ZGJC ne Bashki | Çdo vit | **31, 000** lekë Buxheti vendor | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (MPS) në Bashki |

**Fusha e ndërhyrjes: Aksesi Barabartë në Regjistrimin Civil dhe në Drejtësi**

**Objektivi specifik: 1.** Lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të regjistrimit civil dhe drejtësisë për romët dhe egjiptianët

**Treguesi i Objektivit:** 90% e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian do të kenë akses të plotë në shërbimin e gjendjes civile në fund të vitit 2028.

| **Masa/Aktiviteti** | **Aktorët** | **Treguesit e rezultateve** | **Burimet e të dhënave** | **Afatet** | **Kostimi ne vit** | **Monitorimi** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| që janë lindur brenda dhe jashtë institucioneve shëndetësore | (ASHS) dhe Zyra e Gjendjes Civile (ZGJC), Dega e Policisë së Shtetit | | | | | |
| 1.3 Informimi dhe shpërndarja e paketave të informacionit mbi regjistrimin civil, dokumentacionin e nevojshëm dhe burimet e mbështetjes për romët dhe egjiptianët në lidhje me regjistrimin civil dhe transferimin e vendbanimit | Qendra Komunitare Rome (QKR), Agjensia e Sherbimit Social Bashkia Elbasan (ASHS) dhe Zyra e Gjendjes Civile (ZGJC), | Numri i romëve dhe egjiptianëve e të informuar rreth procedurave e të regjistrimit civil dhe ndryshimit të vendbanimit, Ndarja sipas: etnicitetit. | Raport i paraqitur nga QKR, ASHC, ZGJC në Bashki | Çdo vit | **30,000 Lekë** Buxheti vendor | Drejtoria e Shërbimit Social DMPS në Bashki |

**Fusha e ndërhyrjes: Aksesi Barabartë në Regjistrimin Civil dhe në Drejtësi**

**Objektivi 2:** Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe egjiptianëve në rrezik trafikimi si dhe referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e rasteve të trafikuara.

**Treguesi i objektivit:** Deri në fund të vitit 2027, 90% e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian do të jenë të informuar mbi mënyrat e trafikimit të qënieve njerëzore si dhe 90% e rasteve të trafikuara do të janë marrë në mbrojtje dhe asistohen me shërbimet e riintegrimit të tyre në shoqëri.

| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Kostimi ne vit | Monitorimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1 Informimi i komuniteti rom e egjiptian mbi fenomenin e trafikimit.<br><br>Identifikimi dhe referimi i rasteve VT, VMT tek strukturat përgjegjëse. | Qendra Komunitare Rome (QKR), Agjensia e Shërbimit Social Bashkia Elbasan (ASHS) dhe Zyra e Gjendjes Civile (ZGJC) | Numri i viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimave të identifikuara të trafikimit, që janë referuar dhe kanë marrë ndihmë (M/F) | Bashkia/Sistemi Regjistrit Elektronik Kombëtar | Çdo vit | **30,000 Lekë** Buxheti vendor | DMPS, Agjensia e Shërbimeve Sociale ASHS |

**Fusha e ndërhyrjes: Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor**

**Objektivi specifik 2.1:** Të forcohet bashkëveprimi i shkollës me shërbimet sociale, për adresimin e rasteve të fëmijëve romë dhe egjiptianë me probleme sociale-ekonomike.

Treguesi: 90% e vajzave dhe djemve të komunitetit Rom dhe Egjiptian me probleme sociale-ekonomike do të gjejnë mbeshtetje nga shërbimet sociale si rezultat i koordinimit me institucionet arsimore komunitare.

| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Kostimi ne vit | Monitorimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.1 Identifikimi dhe regjistrimi i të gjithë vajzave dhe djemve romë dhe egjiptianë në moshë të detyrueshme shkollore në shkollë, nëpërmjet grupeve shumë-sektoriale të punës në nivel lokal. | ASHS, QKR, Drejtoria Arsimit, Rinisë dhe Sporteve Bashkia Elbasan, NJVNR\NJA | Numri i vajzave dhe djemve rome dhe egjiptiane të regjistruar çdo vit në arsimin fillor<br><br>(M/F, etnicitetit, qytet/fshat). | Raport i paraqitur nga ASHS, NJVNR, DMPS /Zyra e ArsimitElbasan | Çdo vit | **50.400 Leke** Buxheti vendor | DMPS, Drejtoria Arsimit Rinisë dhe Sporteve Bashkia Elbasan |
| 2.1.2 Organizimi i takimeve periodike me prindër romë dhe egjiptianë në vendbanimet e tyre për cështje që lidhen me | ASHS, QKR, Drejtoria Arsimit Rinisë dhe Sporteve Bashkia Elbasan, | Numri i vizitave derë më derë të kryera nga stafi QKR, punonjësi social ose NJVNR<br><br>Numri i prindërve romë dhe egjiptianë | Raport nga Drejtoria Arsimit Rinisë dhe Sporteve Bashkia Elbasan, shkollave/Drejtoria ZVA Elbasan | Çdo vit | **54,290 lekë** Buxheti vendor | Drejtoria Arsimit Rinisë dhe Sporteve Bashkia Elbasan dhe DMPS |

| **Fusha e ndërhyrjes: Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| rëndësinë e arsimit të detyrueshëm. | NJVNR\NJA | që kanë marrë pjesë në takimet informuese dhe ndërgjegjësuese | | | | |
| 2.1.3 Referimi i familjeve të fëmijëve që braktisin shkollën ose që rrezikojnë të braktisin arsimin e detyrueshëm, në ASHS, NJVNR, QKR dhe burimet e tjera të mbështetjes. | Drejtoria Vendore Arsimore ZVA, QKR, Drejtoria Arsimit Rinisë dhe Sporteve Bashkia Elbasan, | Numri i familjeve të referuara në ASHS për fëmijët që braktisin shkollën.<br>(F/M, Ndarja sipas: etnicitetit, qytet/fshat) | Drejtoria Vendore Arsimore ZVA, ASHS dhe NJVNR | Çdo vit | **25,550 lekë** Fondi i Drejtorise Arsimore / Buxheti vendor | Drejtoria Arsimit Rinisë dhe Sporteve Bashkia Elbasan dhe DMPS |
| **Objektivi specifik 2.2**: Përmirësimi i performancës akademike të fëmjëve Rom dhe Egjiptian<br>**<u>Treguesi</u>:** Rritja me 50% e performancës të nxënësve rome dhe egjiptiane qe përfundojnë arsimin e detyrueshëm. | | | | | | |
| 2.2.1 Promovimi i rasteve të suksesëshme të nxënësve më të mirë Romë dhe Egjiptianë | Shkolla, Drejtoria Arsimore, Zyra e Arsimit Bashki | Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të promovuar. | Raportim i Zyrës së Arsimit në Bashki | Çdo vit | Fondi i Drejtorise Arsimore / Buxheti vendor | DMPS |
| 2.2.2 Mbështetja e fëmijëve rom e egjiptianë në përgatitjen e mësimeve pjesë e | QKR, Qendra ADRA, Qendra A2B, Qendra Multifunksi | Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që përmirësojnë performancën akademike në shkollë. | Raporte nga qendrat komunitare që zbatojnë programin(after school), ASHS | Cdo vit | **142,000 lekë** ASHS Bashkia Elbasan dhe donatoret( | DMPS |

| **Fusha e ndërhyrjes: Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| programeve (after school) pranë qendrave komunitare | onale Shushicë | | | | A2B, ADRA etj) | |
| **Objektivi specifik 2.3**: Përmirësimi i dialogut ndërkulturor dhe mirëkuptimit të përbashkët. | | | | | | |
| 2.3.1 Organizimi i javës së kulturës rome (2-8 Prill) dhe kthimi në një traditë të përvitshme | QKR, Qendra ADRA, Qendra A2B, Qendra Multifunksionale Shushicë, Drejtoria Arsimit Rinisë dhe Sporteve Bashkia Elbasan | Numri indikativ i pjesëmarrësve ne eventet / aktivitetet e kryera | Raporte nga qendrat komunitare që zbatojnë programin(after school), ASHS | Çdo vit | **141,520 Lekë** Bashkia / Fondet e veta dhe donatorë | Bashkia dhe donatorë |
| 2.3.2 Aktivitete për promovimin e identitetit, vlerave kulturore të komuniteteve rome dhe egjiptiane, 24 Qershor | QKR, Qendra ADRA, Qendra A2B, Qendra Multifunksionale Shushicë, Drejtoria Arsimit Rinisë dhe Sporteve | Numri i eventeve/aktiviteteve dhe qëllimi<br><br>Numri inditikativ i pjesëmarresve në cdo aktivitet | Raportim i Bashkisë / Publikime në ëebsite, OSHC, projekte të donatorëve | Çdo vit | **98, 670 lekë** Bashkia / Fondet e veta dhe donatorë | Raporti vjetor I grupit të monitorimit të Planit të Veprimit |

| **Fusha e ndërhyrjes: Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Bashkia Elbasan | | | | | |
| 2.3.3 Promovimi I talenteve në art (këngë dhe instrumenta muzikorë), zeje në aktivitete social-kulturore. | Bashkia/ Qendra sociale komunitare Rome, QKF, mediat lokale/ ZVA | Numri i fëmijeve të identifikuar si talente në aktivitetet e kryera<br><br>Numri i fëmijëve të promovuar më mediat lokale | Bashkia / Qendrat Sociale / Mediat | Çdo vit | **85,000 lekë** Bashkia / Fondet e veta dhe donatorë | Raporti vjetor i grupit tëmonitorimit të Planit të Veprimit |
| 2.3.4 Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit midis organizatave të shoqerisë civile , Bashkisë dhe donatorëvë dhe aktorëve të tjerë vendore që promovojnë dialogun ndërkulturor | Bashkia, partnerët lokalë, OSHC | Numri i aktiviteteve<br><br>Numri indikativ i pjesëmarrësve | Bashkia / OSHC / donatore | Çdo vit | **45,000lek**e Bashkia / Fondet e veta dhe donatorë | Raporti vjetor i grupit të monitorimit të Planit të Veprimit |

| **Fusha e ndërhyrjes: Kujdesi Shëndetësor** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masa/Aktiviteti** | **Aktorët** | **Treguesit e rezultateve** | **Burimet e të dhënave** | **Afatet** | **Kostimi ne vit** | **Monitorimi** |
| **Objektivi specifik: 3.** Përmirësimi i informimit dhe promocionit shëndetësor për shërbimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor për romët dhe egjiptianët.<br><br>**Treguesi i objektivit** : 90% e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian do të kenë informacion të plotë në lidhje me çështjet që ndikojnë në shëndetin e tyre si dhe shërbimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor | | | | | | |
| 3.1 Organizimi i sesioneve informuese mbi strukturat shëndetësore dhe shërbimet që ofrohen | ASHS, QKR, NJVNR, qendrat komunitare, NJVKSH, ZVA dhe Drejtoria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve, Bashkia Elbasan. | Numri i takimeve në komunitet<br><br>Numri indikativ i anëtarëvë pjesëmarrës. | Raportim nga NJVKSH / Qendra komunitare / Bashkia | Çdo vit | **75,747 leke** Buxheti vendor dhe Drejtoria e Shendetesis ë | NJVKSH / Qendra Shëndetësore / Bashkia / Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 3.2 Rritja e kapaciteteve te Grupit Ndërmjetësues pranë komuniteteve rome dhe egjiptiane për të ndërgjegjësuar dhe adresuar problematikat e komunitetit specifikisht | ASHS, QKR, NJVNR, qendrat komunitare, NJVKSH, ZVA dhe Drejtoria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve, Bashkia Elbasan. | Numri i romëve dhe egjiptianëve të rekrutuar dhe të trajnuar si ndërmjetësues | Raportim nga strukturat përgjegjëse / Qendrat komunitare / Bashkia | Çdo vit | **53,000 leke** Buxheti vjetor | NJVKSH / Qendra Shëndetësore / Bashkia / Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| **Fusha e ndërhyrjes: Kujdesi Shëndetësor** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masa/Aktiviteti** | **Aktorët** | **Treguesit e rezultateve** | **Burimet e të dhënave** | **Afatet** | **Kostimi ne vit** | **Monitorimi** |
| lidhur me shërbimet shëndetësore. | | | | | | |
| 3.3 Përgatitja e informacioneve të thjeshta dhe materialeve promocionale për çështjet shëndetësore, (mundësisht edhe në gjuhën rome dhe me figura për fëmijët) | ASHS, QKR, NJVNR, qendrat komunitare, NJVKSH, ZVA dhe Drejtoria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve, Bashkia Elbasan dhe Grupin Ndërmjetësues. | Numri i materialeve promocionale të përgatitura | Materialet promocionale | Çdo vit | **34,800 leke,** Buxheti Vendor | NJVKSH / Qendra Shëndetësore / Bashkia / Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| **Fusha e ndërhyrjes: Punësimi e Formimi Profesional (AFP)**<br><br>**Qëllimi strategjik 4:** Krijimi i mundësive të barabarta për punësimin formal të romëve dhe egjiptianëve. | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi specifik 4.1**: Rritja e aksesit te Romëve dhe Egjiptianëve në formimin profesional dhe në programet e nxitjes të punësimit.<br><br>**Treguesi:** 50% me shumë gra dhe burra romë dhe egjiptianë të cilët marrin pjesë në AFP dhe programet aktive të punësimit do të integrohen në tregun e punës deri në fund te vitit 2027 | | | | | | |
| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Kostimi ne vit | Monitorimi |

**Fusha e ndërhyrjes: Punësimi e Formimi Profesional (AFP)**

**Qëllimi strategjik 4:** Krijimi i mundësive të barabarta për punësimin formal të romëve dhe egjiptianëve.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1.1 Mbështetja përmes informimit e orientimit për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve në programet e nxitjes së punësimit (PNP), | AKPA Elbasan / ASHS,Bashkia/ | Numri i romëve dhe egjiptianëve (meshkuj dhe femra) që përfshihen në PNP | Raportim i AKPA Elbasan | Çdo vit | **41,140 leke** - AKPA Elbasan,Bashkia/ | AKPA Elbasan / DMPS,Bashkia/, AKPA Elbasan Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 4.1.2 Perfshirja e individëve nga komunitet rome e egjiptiane në punët komunitare (Program nxitje punësimi) | AKPA Elbasan / ASHS,Bashkia/ | Numri i punëve komunitare të kryera | Raportim i AKPA Elbasan /ASHS,Bashkia | Çdo vit | **360,000leke** - AKPA Elbasan, Bashkia | DMPS,Bashkia/,AKPA Elbasan, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 4.1.3 Dhënia e bursave të plota për studentët romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin dhe formimin profesional, në një nivel që të mbulojë koston e jetesës tarifat e regjistrimit | MSHMS / Drejtoria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve, Bashkia | Numri i personave rome dhe egjiptianë përfitues (F/M, etniciteti) | Raportim Bashkisë | Çdo vit | Sipas Kostimitt e MSHMS | Bashkia / DMPS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

**Fusha e ndërhyrjes: Punësimi e Formimi Profesional (AFP)**

**Qëllimi strategjik 4:** Krijimi i mundësive të barabarta për punësimin formal të romëve dhe egjiptianëve.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1.4 Trajnime dhe këshillime për zhvillimin e aftësive të jetës me fokus të rinjtë rome dhe egjiptianë në qëndren komunitare | Qendrat komunitare Bashkia Elbasan, donatorë dhe AKPA. | Numri i personave të këshilluar (të paktën 1 trajnim/këshillim i organizuar) në vit | Raportim nga qendrat komunitare/ ASHS (Bashkia) | Çdo vit | **58,000lek** e AKPA Elbasan,Bashkia/ donatorë | DMPS Bashkia , Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 4.1.5 Promovimi i rasteve të suksesëshme të personave romë dhe egjiptianë të punësuar nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit. | Bashkia/ASHS / Qendra komunitare /AKPA | Numri i rasteve të promovuara | Raportim nga qendra komunitare/ ASHS (Bashkia) | Çdo vit | **65,000lek** e- AKPA Elbasan,Bashkia/ donatorë | DMPS Bashkia , Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 4.1.6 Formalizimi i kuotave që mundësojnë punësimin e romëve dhe egjiptianëvë në administratën publike dhe institucionet në varësi të Bashkisë. | Këshilli Bashkiak / DMPS | Vendosja e kuotave dhe rritje me 2% e numrit të personave të punësuar cdo vit për periudhën e zbatimit të Planit të Veprimit | Bashkia / DMPS / Drejtoria e Burimeve Njerëzore (DBNJ) | Çdo vit | **35,000 leke , bashkia** | Bashkia/DMPS/ DBNJ |
| 4.1.7 Krijimi i programit të punëve në komunitet – | Bashkia / Drejtoria e Programimit dhe | Numri i romëve dhe egjiptianëve të përfshirë në | Bashkia / DMPS | Çdo vit | **960.000 leke** Bashkia (fondet e | Bashkia/DMPS/ DBNJ |

**Fusha e ndërhyrjes: Punësimi e Formimi Profesional (AFP)**

**Qëllimi strategjik 4:** Krijimi i mundësive të barabarta për punësimin formal të romëve dhe egjiptianëve.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| investime publike duke përfshire përfitues nga skema e NE, si dhe romë dhe egjiptianë | Zhvillimit/ ASHS/Donatore/Sektori Privat | punët në komunitet | | | veta) / projekte të investimeve nga donatorë | |
| 4.1.8 Ofrimi i granteve të vogla me qëllim nxitjen e punësimit dhe formalizimin e punëve (përfshirë artizanët), me focus gratë, të rinjtë romë dhe egjiptianë | Bashkia<br>Projekte të donatorëve | Numri i granteve të ofruara<br>Fondi i granteve (në lekë)<br>Numri i romëve dhe egjiptianëve te punësuar / ose formalizuar | Bashkia / Drejtoria e Buxhetit e Financës / DMPS | Çdo vit | **1,000,000lekë** Bashkia (fondet e veta) / projekte të investimeve nga donatorë | Bashkia/DMPS/ Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 4.1.9 Lehtësimi e mbështetja e ndërmarrjeve sociale që kanë target punësimin e romëve dhe egjiptianëve. | Bashkia, Projekte të donatorëve | Numri i ndërmarrjeve sociale ose bizneseve qe jane mbështetur (lehtësuar) nga taksat e Bashkisë<br>Numri i personave romë dhe egjiptianë të punësuar | Bashkia / Drejtoria e Buxhetit e Financës | Çdo vit | **530,000lekë** Bashkia (fondet e veta) / projekte të investimeve nga donatorë | Bashkia/DMPS/ Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| Fusha e ndërhyrjes: Strehimi dhe integrimi urban<br><br>Qëllimi strategjik 5:Përmirësimi i kushteve të banimit dhe infrastrukturës urbane të zonave të banimit të romëve dhe egjiptianëve | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa/Aktivitet i | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Kostimi | Monitorim i |
| **Objektivi specifik 5.1**: Rritja e aksesit te Romëve dhe Egjiptianëve në programete strehimit social<br><br>**Treguesi:** 30% më shumë familje jetojne në kushtë të përmiresuara banimi. | | | | | | |
| 5.1 Ofrimi i ndihmës nga Bashkia për familjet rome dhe egjiptiane për përmiresimin e kushteve të banesave nëpërmjet aplikimeve cdo vit për financim nga programet e strehimit social | Bashkia/Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban | Numri i projekteve / aplikimeve të përgatitura cdo vit nga Bashkia<br><br>Numri i projekteve te miratuara per financim nga MFE | Raportim iBashkise/ Drejtoria e Zhvillimit Urban/DSHS | Çdo vit | Sipas kostimit bere nga bashkia | Bashkia / DMPS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 5.2 Planifikimi dhe kryerja e investimeve për përmirësimin e infrastruktures urbane (sistemi i furnizimit me ujë, rruge dhe trotuarë, sistemi i mbledhjes se | Bashkia / Drejtoria e Planifikimit e Zhvillimit Urban / Drejtoria e Buxhetit/Financës | Numri i projekteve për ndërhyrje dhe përmirësim të infrastrukturës urbane të zonave të banimit me përqëndrim të<br><br>Fondi i investimit ne lekë, Numri i familjeve me impakt pozitiv (përfituese) | Drejtoria e Zhvillimit Urban/DMPS | Çdo vit | **Sipas studimit te fizibilitetit nga bashkia** | Bashkia / DMPS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| **Fusha e ndërhyrjes: Strehimi dhe integrimi urban**<br><br>**Qëllimi strategjik 5:**Përmirësimi i kushteve të banimit dhe infrastrukturës urbane të zonave të banimit të romëve dhe egjiptianëve | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa/Aktivitet i | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Kostimi | Monitorim i |
| mbetjeve urbane) - | | | | | | |
| 5.3 Fushatë informimi e ndërgjegjësimi rreth programeve të strehimit social dhe menyrat e aplikimit për romët dhe egjiptianët | Drejtoria e Strehimit Bashkia / Zyra e Informacioni t Bashkia Elbasan | Numri i takimeve informuese<br><br>Numri i personave romë dhe egjiptianë të informuar | Raportim i Bashkisë | Çdo vit | **85,000le ke** Bashkia / fondet e veta | Bashkia / DMPS / Sektori i strehimit, Raporti vjetor i grupit të monitorim it |
| 5.4 Ofrim asistence për plotësimin e dokumentacion it në programet e strehimit social (dhe bonus qeraje) | Drejtoria e Strehimit, Zyra e Informacioni t Bashkia Elbasan | Numri i personave rome dhe egjiptianëtë asistuar | Raportim i Bashkisë | Çdo vit | **38,000le kë** Bashkia | Bashkia / DMPS / Sektori i strehimit, Raporti vjetor i grupit të monitorim it |

| **Fusha e ndërhyrjes: Mbrojtja Sociale**<br><br>**Qëllimi strategjik 6:Përmirësimi i përfshirjes së anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në programet e mbrojtjes sociale** |
|---|
| **Objektivi specifik 6.1** : Rritja e aksesit të Romëve dhe Egjiptianëve në programet e shërbimeve sociale |

**Fusha e ndërhyrjes: Mbrojtja Sociale**

**Qëllimi strategjik 6:Përmirësimi i përfshirjes së anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në programet e mbrojtjes sociale**

**Treguesi:** 65% e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian do të jenë të përfshirë në programet e mbrojtjes sociale deri në fund të vitit 2027

| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Kostimi | Monitorimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.1.1 Fushata informimi dhe ndërgjegjësimi rreth programeve të mbrojtjes sociale (ndihme ekonomike, pensione sociale, pagesë papunësie, pagesë paaftësie) | Bashkia / ASHC | Numri i fushatave<br>Numri i personave romë dhe egjiptianë të informuar | Bashkia / DMPS | Çdo vit | **91,000leke-** Bashkia (fondet e veta) | Bashkia / DMPS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 6.1.2 Ofrimi i asistencës në plotësimin e formularëve për ndihmë ekonomike, pensione sociale, pagesë papunësie, pagesë paaftësie) | Bashkia / ASHC | Numri i aplikimeve (rritje me 3-5% të numrit të palikimeve cdo vit) | Raportim i Bashkise/ /DMPS | Çdo vit | **29,300leke** Bashkia (fondet e veta ) | Bashkia / DMPS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 6.1.3 Trajnime të administratorëve socialë dhe stafeve të NJVNR lidhur me shërbimet sociale, legjislacionin, dhe fusha të tjera relevante | Bashkia / DMPS / Qendra Komunitare Rome QKR/ MSHMS | Numri i trajnimeve<br>Numri i personave (staf i Bashkisë) të trajnuar | Raportim nga Bashkia / DMPS | Çdo vit | **38,000leke** Bashkia (fondet e veta) / MSHMS / projekte të donatorëve | Bashkia / DMPS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 6.1.4 Forcimi i ekipeve të lëvizshme (administrator social, lehtësues komuniteti, qendër komunitare) për të identifikuar, | Bashkia / ASHC, QKR, NJVNR | Raport vlerësimi. Numri i personave romë dhe | Raportim nga Bashkia / DMPS | Çdo vit | **82,045 leke** Bashkia (fondet e veta), donatorë | Bashkia / DMPS, Raporti vjetor i grupit të |

| **Fusha e ndërhyrjes: Mbrojtja Sociale**<br><br>**Qëllimi strategjik 6:Përmirësimi i përfshirjes së anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në programet e mbrojtjes sociale** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| vlerësuar/adresuar nevojat social-ekonomike të familjeve /individëve romë dhe egjiptianë si edhe për organizimin e fushatave ndërgjegjësuese në komunitet në lidhje me martesat e hershme | | egjiptianë të informuar | | | | monitori mit |
| 6.1.5 Organizimi i fushatave qytetare/aktiviteteve sociale solidare "Shporta për Ju" për ndihma ushqimore, veshmbathje për më të varfërit | Bashkia / ASHS, QKR, DMPS | Numri i fushatave<br><br>Numri i familjeve përfituese | Raportim Bashkisë | Çdo vit | **132,000leke** Bashkia/OJF | Bashkia / DMPS |

| **Koordinimi, Monitorimi dhe Vlerësimi i Treguesve të Integrimit të Pakicave si pjesë e Planit të Mbrojtjes Sociale** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 6.2:** Monitorimi i zbatimit të masave dhe treguesve të planit të veprimit me të gjitha institucionet në nivel vendor për të reduktuar pabarazinë social – ekonomike të R/E dhe për te rritur aksesin në shërbimet publike.<br><br>**Treguesi:** Publikimi i raportit të progresit cdo vit. | | | | | | |
| **Masa/Aktiviteti** | **Aktorët** | **Treguesit e rezultateve** | **Burimet e të dhënave** | **Afatet** | **Fondet/Financimi** | **Monitorimi** |
| 6.2.1 Organizimi i takimeve (të paktën) çdo gjashtë muaj me lehtësuesit për komunitetin rom | Bashkia/Grupi i punës/DMPS/ ASHC, Qendra Komunitare Rome QKR/ | Numri i takimeve, list-prezenca, axhenda e takimeve | Evidenca të takimeve | Çdo 6 muaj | **48,000leke** Fond i Bashkise (pa kosto shtesë) | Bashkia / DMPS /qendra komunitare/lehtësuesi |

| Koordinimi, Monitorimi dhe Vlerësimi i Treguesve të Integrimit të Pakicave si pjesë e Planit të Mbrojtjes Sociale | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| dhe egjiptian dhe OSHC për adresimin e problematika te komunitetit. | lehtësuesit (pikat e kontaktit) | | | | | |
| 6.2.2 Përditësimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit online (ROMALB) me të dhëna të reja nga përdoruesi në nivele të ndryshme | Bashkia/DMPS (koordinatori per sistemin ROMALB), MSHMS | Seti i treguesve përditësuar | Treguesit e përditësuar | Çdo vit | **60,300leke** Fond i Bashkisë (pa kosto shtesë) | MSHMS |

**KRYETARI**

**Gledian Llatja**